FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 89

Tiranë – E mërkurë, 9 qershor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Rezolutë e Kuvendit datë 3.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2020	9009
Rezolutë e Kuvendit datë 3.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2020	9010
Rezolutë e Kuvendit datë 3.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për vitin 2020	9012
Rezolutë e Kuvendit datë 3.6.2021	Për vlerësimin e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për vitin 2020 (shkurt–dhjetor)	9013
Rezolutë e Kuvendit datë 3.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2020	9014
Rezolutë e Kuvendit datë 3.6.2021	Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2020	9016
Dekret i Presidentit nr. 13089, datë 7.6.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare	9017
Dekret i Presidentit nr. 13090, datë 7.6.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare	9017
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 2.6.2021	Për caktimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza", si aeroport rezervë i Forcave të Armatosura, gjatë gjendjeve për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme	9017
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324, datë 2.6.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 230, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shpalljen, kategorizimin dhe emërtimin e portit të llojit MBM, në Porto-Romano, Durrës, 'Port i hapur për trafik ndërkombëtar'"	9018

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 2.6.2021	Për miratimin e kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat, për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA).....	9018
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 327, datë 2.6.2021	Për mekanizmin e bashkërendimit të punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe procedimin e tij, për mbështetjen e rehabilitimin e viktimave të dhunës.....	9019
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 331, datë 2.6.2021	Për miratimin e ndryshimit të statusit nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 1/68, zona kadastrale 3529, Bashkia Pogradec.....	9029
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 2.6.2021	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, për pagesën e studios për çështjen e anulimit të vendimit të arbitrazhit ICSID Case nr. ARB/14/26.....	9030
Urdhër i përbashkët i ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 64, datë 30.3.2021	Për ngritjen dhe përbërjen e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe të Komunikimit.....	9030
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 25, datë 10.5.2021	Me objekt shfuqizimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 28.6.2019, "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Zef Hila", si të papajtueshëm me Kushtetutën.....	9031
Vendim i Bankës së Shqipërisë nr. 28, datë 2.6.2021	Për dhënien e miratimit paraprak, për zotërimin nga shoqëria "Eurosig" sh.a. të 21.02 për qind të kapitalit aksionar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a.....	9047
Udhëzim i Bankës së Shqipërisë nr. 1, datë 2.6.2021	Për mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të lekut në Bankën e Shqipërisë.....	9047
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 6822, datë 7.6.2021	Mbi hyrjen në fuqi të një marrëveshjeje ndërkombëtare.....	9050
Kërkesë e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ekonomisë nr. 4675, datë 4.6.2021	Për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksion i rrugës 'Mujo Ulqinaku' (segmenti i dytë) dhe rrugës 'Jakov Mile' (segmenti i parë), Fier".....	9051
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetases Marsije Daja.....	9051

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK, PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur Komisionin e Prokurimit Publik si organin më të lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligj;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm për KPP-në paanësinë në vendimmarrje, transparencën, efikasitetin, si dhe mbrojtjen e interesave të ligjshme të operatorëve ekonomikë nga veprimet ose mosveprimet e autoriteteve kontraktore dhe në mënyrë të veçantë mbrojtjen e interesit publik;

Duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm rolin që KPP-ja ka në rritjen e efikasitetit dhe të besueshmërisë në sistemin e prokurimit publik,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2020, në drejtim të:

Trajtimit të 329 ankesave të paraqitura nga 741 ankesa gjithsej gjatë vitit 2020;

Marrjes së 609 vendimeve nga Komisioni i Prokurimit Publik, nga të cilat 64 janë vendime për ankesat e mbartura nga viti 2019 dhe 545 janë vendime për ankesat e ardhura gjatë vitit 2020;

Ndjekjes së procedurave për miratimin në Kuvend të strukturës dhe organikës së institucionit të KPP-së, e cila u miratua me vendimin nr. 65, datë 29.10.2020 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së KPP-së", vendim i cili hyri në fuqi më 29 tetor 2020;

Trajnimit të punonjësve të administratës së KPP-së nëpërmjet *webinar*-eve për përditësimin, pasurimin dhe shkëmbimin e eksperiencave të tyre;

Kthimit të shumave të paguara nga ana e operatorëve ekonomikë ankimues, të cilëve u është pranuar ankesa në bazë të vendimeve të marra deri në datën 31 dhjetor 2020;

Derdhjes në buxhetin e shtetit të pagesave të bëra nga ankimuesit, të cilëve nuk u është pranuar ankesa nga KPP-ja;

Realizimit të shumës totale prej 187.981.945 lekësh si të ardhura jashtëbuxhetore nga parapagimi i tarifave financiare të operatorëve ekonomikë ankimues pranë KPP-së;

Marrjes së 64 vendimeve nga 98 ankesa të mbartura nga viti 2019;

Ngritjes së një strukture të posaçme pranë KPP-së për moszbatimet në kohë të vendimeve të dhëna nga KPP-ja, nga ana e autoriteteve kontraktore;

Hartimit të rekomandimit të përbashkët mes KPP-së dhe Agjencisë së Prokurimit Publik (APP), nr. 1474 prot., datë 11.11.2020 (KPP) dhe nr. 7267 prot., datë 11.11.2020 (APP);

Referimit të çështjeve pranë APP-së për hetim administrativ të mëtejshëm;

Bashkëpunimit të institucionit të KPP-së me Universitetin e Tiranës, Universitetin Politeknik të Tiranës, Shkollën e Magjistraturës, ASPA-n, APP-në, AKSHI-n për çështje të ndryshme të shtjelluara në raportin vjetor 2020;

Miratimit të rregullores për funksionimin e institucionit të KPP-së gjatë pandemisë me vendimin nr. 500/2020;

Përfshirjes së 25 ekspertëve dhe 2 laboratorëve të akreditуar, miratuar me vendimin nr. 566/2020, datë 10.12.2020, "Për miratimin e listës vjetore të ekspertëve dhe specialistëve të pavarur, si dhe të laboratorëve të akreditуar për vitin 2021";

Nënshkrimit *online* të Memorandumit të Mirëkuptimit në datën 5.10.2020, mes KPP-së dhe *Open Contracting Partnership* (*OCP*), me qëllim zbatimin e një standardi të ri të publikimit të veprimtarisë së KPP-së nëpërmjet publikimit të të dhënave bazuar në parimet *open data.*

Kuvendi kërkon që Komisioni, për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të vijojë dhe përfundojë procesi për plotësimin e strukturës së KPP-së brenda vitit 2021.

2. Të merren masa konkrete për bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës, Gjykatën Administrative sa i takon trajnimit të punonjësve të të dyja institucioneve, me qëllim aftësimin e tyre për të trajtuar çështje komplekse të prokurimit publik, brenda vitit 2021.

3. Të vijohet puna e nisur në fund të vitit 2020 nga ana e KPP-së për plotësimin e Regjistrit Elektronik të Ankesave me elementet shtesë të nevojshme, siç janë lloji i procedurës dhe fondi limit për çdo procedurë prokurimi objekt ankimi, e të përfundojë brenda vitit 2021.

4. Të përfundohet procesi i rishikimit të rregullores për organizimin dhe funksionimin e KPP-së, duke e miratuar atë brenda vitit 2021.

5. Të merren masa për plotësimin e informacionit për secilin vendim të marrë gjatë vitit 2020, duke u pasqyruar në faqen zyrtare të KPP-së, në kuadër të transparencës ndaj qytetarëve që aksesojnë këtë faqe, brenda 2 muajve nga publikimi i rezolutës së Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionit të Prokurimit Publik, për vitin 2020".

6. Të ndiqet dhe të zbatohet Memorandumi i Mirëkuptimit i nënshkruar *online* në datën 5.10.2020, mes KPP-së dhe *Open Contracting Partnership* (*OCP*), me qëllim zbatimin e një standardi të ri të publikimit të veprimtarisë së KPP-së, nëpërmjet publikimit të të dhënave bazuar në parimet *open data*.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE, PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e veçantë të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në promovimin, garantimin, si dhe nxitjen e standardeve më të larta në ushtrimin e të drejtave themelore të njeriut, të cilat i ka në thelb të veprimtarisë së tij, si e drejta për informim dhe mbrojtja e të dhënave personale;

Duke vlerësuar rolin e këtij institucioni në intensifikimin e përpjekjeve për përafrimin e kuadrit ligjor, mbi bazën e të cilit ushtron veprimtarinë e tij me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian dhe të akteve të tjera ndërkombëtare me fuqi detyruese;

Duke vlerësuar rolin e veçantë në garantimin e së drejtës për mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve gjatë periudhës së pandemisë të shkaktuar nga përhapja e virusit COVID-19 nëpërmjet miratimit të udhëzuesve dhe dhënies së orientimeve për kontrollues publik dhe privat për interpretimin e legjislacionit dhe për përpunimin e drejtë të të dhënave personale;

Duke mbështetur dhe inkurajuar bashkëpunimin me shoqërinë civile, medien, publikun, si dhe me institucionet e tjera publike në nivel qendror e vendor,

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi veprimtarinë e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2020 dhe konstaton, se:

Është angazhuar në forcimin e rolit të personit të kontaktit për mbrojtjen e të dhënave personale dhe publikimit të "politikave të privatësisë" në faqen zyrtare të kontrolluesve publikë dhe privatë, si një hallkë e rëndësishme në procesin e garantimit të sigurisë së përpunimit të të dhënave personale;

Është angazhuar në monitorimin dhe mbikëqyrjen e kontrolluesve me fokus platformat *online*, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit ose sektorë që përpunojnë të dhëna sensitive, duke hartuar edhe një raport të posaçëm për rezultatet, gjendjen dhe nivelin e adresimit të problematikave nga institucionet e përfshira;

I ka kushtuar vëmendje të veçantë sektorit të shëndetësisë, diktuar natyrshëm nga situata e pandemisë, e krijuar nga përhapja e virusit COVID-19, nëpërmjet dhënies së asistencës dhe mbështetjes ndaj organeve ligjzbatuese të pozicionuara në vijën e parë të luftës kundër COVID-19, duke miratuar akte të dedikuara posaçërisht dhënies së orientimeve për përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale.

Ka rritje të numrit të rekomandimeve në raport me vitin 2019 për kontrollues publikë dhe privatë, duke synuar ndërgjegjësimin e tyre;

Ka luajtur një rol proaktiv, në kuadër të përmbushjes së angazhimeve ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale, siç është përafrimi i legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale me *acquis* të BE-së në këtë fushë, si dhe miratimi në parim i protokollit ndryshues të Konventës 108;

Ka dhënë kontribut kryesor në plotësimin e kuadrit ligjor për të drejtën e informimit, si miratimi në parim i Konventës së Këshillit të Evropës për aksesin në dokumentet zyrtare dhe përafrimi i direktivës 2019/1024, "Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik";

Ka vijuar punën për përmirësimin e procedurave për shqyrtimin e ankesave, si dhe nxitjen e autoriteteve publike, për të vënë në dispozicion të publikut informacionin pa kërkesë;

Ka realizuar dy indekse të transparencës proaktive, përkatësisht të institucioneve qendrore

dhe të varësisë dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, përfshirë metodologjinë e studimit dhe një grup treguesish të transparencës;

Ka kryer hetime administrative me fokus monitorimin e programeve të transparencës duke rekomanduar ose vendosur sanksione administrative ndaj autoriteteve publike, të cilat nuk e kanë zbatuar atë;

Është angazhuar në organizimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjësuese për respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjes së të dhënave personale, duke shfrytëzuar mjetet digjitale të komunikimit, si: takime *online*, *webminar*-e, *newsletter* mujore etj.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Zyra e Komisionerit për vitin 2021, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

- Të vijojë të mbështesë dhe të monitorojë autoritetet publike për vënien në zbatim të Programit të Transparencës të rishikuar dhe Regjistrit të Kërkesave dhe të Përgjigjeve;

- Të gjejë mekanizmat për të ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit të koordinatorëve për të drejtën e informimit dhe nëpunësve të administratës shtetërore për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit dhe përdorimin e regjistrit elektronik të kërkesave dhe të përgjigjeve;

- Të ndërmarrë hapa institucionalë dhe ligjorë me autoritetet përkatëse për adresimin e plotë të kërkesave të pikës 1, të nenit 14, të ligjit nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit" (trajtimi i kërkesave dhe i ankesave për informacion nëpërmjet portalit unik qeveritar *e-Albania*).

- Të vijojë mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga kontrolluesit publikë dhe privatë të sektorit të kujdesit shëndetësor;

- Të angazhohet në përgatitjen e një rekomandimi unifikues në fushën e shëndetësisë;

- Të monitorojë dhe të mbikëqyrë zbatimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale në sektorin e arsimit, veçanërisht në lidhje me masat teknike dhe organizative të marra nga kontrollues të këtij sektori për të garantuar sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale në kontekstin e mësimdhënies *online*, të diktuar nga situata e shkaktuar nga përhapja e pandemisë COVID-19;

- Të monitorojë dhe të mbikëqyrë respektimin e legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale nga subjektet kontrolluese që ushtrojnë veprimtari tregtimi të drejtpërdrejtë.

- Të përforcojë bashkërendimin institucional me kontrolluesit publikë për të vijuar mbikëqyrjen dhe monitorimin në funksion të rikuperimit të problematikave të konstatuara në raportin e zyrës së Komisionerit për mbikëqyrjen e kontrolluesve, me fokus platformat *online*, sektorin e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit, si dhe kontrolluesit publikë dhe privatë të sektorit të kujdesit shëndetësor;

- Të vijojë me dhënien e kontributit në përafrimin e legjislacionit të mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin përkatës të BE-së, konkretisht me Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave Personale 2016/679 (GDPR) dhe Direktivën e Policisë 2016/680 (realizimin me sukses të projektit të binjakëzimit që po asiston Zyrën e Komisionerit në këtë kuadër);

- Të fuqizojë dhënien e kontributit dhe angazhimin aktiv në grupet ndërkombëtare të punës, në kuadër të Asamblesë Globale të Privatësisë (GPA), Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) dhe Konferencës Evropiane të Autoriteteve të Mbrojtjes së të Dhënave Personale (ECDPA);

- Të zhvillojë aktivitete ndërgjegjësuese, trajnuese dhe promovuese për fushat e veprimtarisë, me qëllim ushtrimin në praktikë të të drejtave të qytetarëve, me fokus nxënësit e arsimit parauniversitar, studentët ose përfaqësues të komuniteteve minoritare etnike/kulturore.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL, PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit, në drejtim të përmbushjes së misionit të vet parësor për garantimin e zbatimit të ligjit në administrimin e shërbimit civil në të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, me qëllim që ky proces të jetë i ndershëm, objektiv, i paanshëm dhe transparent;

Duke njohur përpjekjet e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil drejt krijimit të një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional, të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike;

Duke marrë në konsideratë gatishmërinë e Komisionerit për të bashkëpunuar me të gjitha institucionet që kanë për detyrë realizimin e reformës në administratën publike, si një nga prioritetet më të rëndësishme që duhen përmbushur për anëtarësimin e vendit në Bashkimin Evropian,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit, për vitin 2020, në drejtim të:

Përmbushjes së rekomandimeve të lëna nga Kuvendi, në rezolutën e datës 4.6.2020, "Për vlerësimin e veprimtarisë së Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil për vitin 2019";

Mbikëqyrjes së 9 institucioneve të varësisë së administratës shtetërore, ku janë verifikuar 842 pozicione pune;

Vijimit të procesit për konsolidimin e databazës dhe zgjidhjes së problemeve që dalin gjatë ekzekutimit të vendimeve gjyqësore, për rikthimin në detyrë të nëpunësve civilë gjyqfitues;

Realizimit të mbikëqyrjes së rekrutimeve pranë DAP-it, duke monitoruar procedurat e konkurrimit për rekrutimin në grup, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë në administratën shtetërore për 880 pozicione pune;

Përfshirjes në një proces të mbikëqyrjes së orientuar të institucioneve të vetëqeverisjes vendore, bashki dhe këshilla qarku, me qëllim mbledhjen e të dhënave për të njohur situatën e administrimit të shërbimit civil;

Realizimit të mbikëqyrjes së orientuar për mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e procesit të lirimit nga shërbimi civil të punonjësve që kanë plotësuar moshën për të dalë në pension të plotë pleqërie;

Vijimit të procesit të verifikimit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit pas përfundimit të afatit të paralajmërimit, si për subjektet e mbikëqyrura, ashtu edhe për inspektimet individuale, të lidhura me trajtimin e ankesave të nëpunësve civilë.

Kuvendi kërkon që Komisioneri, për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të hartojë një analizë të detajuar të shkaqeve për vendet e paplotësuara në pozicionet e shërbimit civil në institucionet e pavarura, administratën publike dhe institucionet e vetëqeverisjes vendore.

2. Të bëhen përpjekje për vijimin e asistencës dhe këshillimit të njësive përgjegjëse të administrimit të shërbimit civil në nivel vendor për zbatimin e ligjit, gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të strukturave finale, hartimit dhe miratimit të përshkrimit të punës.

3. Të ushtrojë mbikëqyrje të vazhdueshme ndaj institucioneve përgjegjëse të administratës publike, në lidhje me proceset e rekrutimit, ngritjes në detyrë dhe shkarkimit, me qëllim sigurimin e zbatimit korrekt të standardeve ligjore.

4. Të vlerësohet impakti i punësimit të studentëve të ekselencës, duke referuar numrin konkret të këtyre studentëve që janë aktualisht pjesë e shërbimit civil.

5. Të hartojë një raport vlerësimi për impaktet e zbatimit të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, që nga miratimi i tij, duke evidentuar arritjet dhe aspekte të ligjit të cilat duhen përmirësuar nëpërmjet ndryshimeve.

6. Në bashkëpunim me institucionet që punësojnë nëpunës civilë, të hartojë një raport të posaçëm me gjetjet nga monitorimi i sjelljes së nëpunësit civil gjatë periudhës zgjedhore, për vitin 2021, dhe t'i vihet në dispozicion Kuvendit të Shqipërisë.

7. Të përditësojë dhe pasurojë me informacion rubrikat në faqen zyrtare të KMSHC-së, për të siguruar transparencë dhe për të informuar në vazhdimësi përfituesit e informacionit.

8. Të angazhohet në zbatimin në terma konkretë të marrëveshjes midis KMSHC-së dhe KLSH-së në të gjitha pikat e saj, duke koordinuar

gjetjet nga auditimi dhe inspektimi, me qëllim mbulimin me kontroll të administratës publike në nivel qendror dhe vendor.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E PUNËS SË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, PËR VITIN 2020 (SHKURT–DHJETOR)

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe për fillimin e procedurës disiplinore ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe të zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet ankesave të paraqitura nga çdo person fizik ose juridik, por edhe kryesisht bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorin e Përgjithshëm, në kuadër të përmbushjes së detyrave funksionale;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me partnerët ndërkombëtarë,

Vlerëson punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në drejtim të:

- Transferimit dhe të nisjes së shqyrtimit fillestar të një numri të madh ankesash lidhur me veprimtarinë e magjistratëve, organizimin e burimeve njerëzore, si dhe nisjen e procesit të rekrutimit të inspektorëve dhe stafit të Zyrës.

- Raportimeve të detajuara vjetore dhe periodike, si dhe informimeve drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe Kuvendit të Shqipërisë për aktivitetin e institucionit.

- Angazhimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë institucionale në zbatim të nenit 204, shkronja "c", të ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

Bazuar në analizën e të dhënave për periudhën shkurt–dhjetor 2020, të referuara në raportin e paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Kuvendi i Shqipërisë konstaton:

- Angazhimin për fillimin e shqyrtimit të një numri prej 3054 ankesash të regjistruara nga muaji shkurt deri në dhjetor 2020.

- Miratimin e 8 vendimeve për fillimin e hetimit disiplinor, përkatësisht 6 hetime disiplinore të iniciuara kryesisht dhe 2 hetime disiplinore të iniciuara pas rasteve të paraqitura nga institucionet pranë ILD-së.

- Dhënien e 184 vendimeve për shqyrtim të ankesave, nga të cilat për 142 janë dhënë vendime për arkivimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar dhe 42 vendime për verifikimin e ankesave pas shqyrtimit fillestar.

- Pas kryerjes së procedurave të verifikimit, miratimin e 7 vendimeve për fillimin e hetimeve disiplinore ndaj magjistratëve, si dhe paraqitjen e 4 kërkesave për fillimin e procedimeve disiplinore pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

- Inicimin e inspektimit tematik pranë gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit, si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre për trajtimin e kërkesave me objekt "Lirim me kusht".

- Hartimin, përpunimin dhe miratimin e "Planit strategjik dhe planit të veprimit 2020–2022".

- Hartimin dhe miratimin e Kodit të Etikës së institucionit.

- Hartimin dhe miratimin e modelit të formularit të ankesës.

- Rezultate konkrete të mekanizmave të procedimit disiplinor të disa magjistratëve, duke i shërbyer kështu kthimit të besimit të publikut tek institucionet e drejtësisë, si një rezultat i prekshëm i reformës në drejtësi.

- Ngritjen nga e para të infrastrukturës fizike e njerëzore të një institucioni krejt të ri si në formë, ashtu edhe në përmbajtje.

Bazuar sa më sipër, Kuvendi i Shqipërisë nxit Inspektorin e Lartë të Drejtësisë:

1. Të veprojë me ritme të shpejta për shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

2. Të forcojë më tej bashkëpunimin me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë dhe institucionet e tjera shtetërore, në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi për të gjitha proceset që ndikojnë në zbatimin e detyrave të përcaktuara.

3. Të informojë vazhdimisht Kuvendin e Shqipërisë për problematikat e hasura gjatë ushtrimit të detyrave, duke rekomanduar edhe zgjidhjet përkatëse.

Kuvendi i rekomandon Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

1. Krijimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve për procedurën hetimore, hartimin e dispozitave të hollësishme për administrimin e këtij sistemi, si dhe bërjen publike të informacionit të pjesshëm, sipas përcaktimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në përputhje dhe në zbatim të nenit 137, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

2. Ngritjen e bazës së të dhënave për ankesat e transferuara nga ish-KLD-ja dhe të administruara nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me qëllim grupimin e tyre dhe hartimin e një radhe përparësore shqyrtimi.

3. Bashkërendimin e punës dhe shkëmbimin e vazhdueshëm të informacioneve me KLGJ-në, KLP-në dhe organet e rivlerësimit kalimtar, që janë përgjegjëse për sistemin e karrierës së magjistratëve, lidhur me ekzistencën ose jo të procedurave disiplinore të nisura ose ankesave të depozituara pranë ILD-së për magjistratët që aplikojnë për ngritje në detyrë brenda sistemit të karrierës.

4. Forcimin e marrëdhënieve institucionale me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, me qëllim trajtimin në afate të arsyeshme të procedimeve disiplinore për prokurorët.

5. Vijimin me ritme të shpejta të punës për hartimin e manualit të hetimit disiplinor, hartimin e rregullores për trajtimin e ankesave dhe metodologjisë për inspektimin.

6. Vijimin me ritme të shpejta të punës për përfundimin e procedurave të rekrutimit të inspektorëve pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

7. Hartimin dhe miratimin e planit vjetor të inspektimeve institucionale e tematike dhe bërjen publik të tij në faqen zyrtare të institucionit.

8. Promovimin dhe rritjen e ndërveprimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me qytetarët nëpërmjet aktiviteteve, informimeve periodike, pasurimit informativ të faqes, duke përdorur çdo kanal tjera të komunikimit publik.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONERIT PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI, PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD) si autoriteti përgjegjës që siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi, nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin dhe nga kushdo;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit efektiv të organeve të barazisë dhe respektimit të standardeve për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, të parashikuara në legjislacionin shqiptar dhe ndërkombëtar për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rëndësinë e forcimit të mekanizmave institucionalë të barazisë në shoqëri dhe rolin e tyre për funksionimin e një shoqërie demokratike, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse, pa diskriminim dhe intolerancë;

Duke mbështetur dhe nxitur bashkëpunimin me këtë institucion, si dhe bashkëpunimin e tij me institucionet e tjera në nivel qendror e vendor, shoqërinë civile, medien dhe publikun,

Vlerëson veprimtarinë e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, gjatë vitit 2020, në këto drejtime:

- Monitorimin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus të veçantë fëmijët në arsim, fëmijët me aftësi të veçanta, fëmijët romë dhe egjiptianë;

- Rritjen e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe edukuese për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi, mjetet ligjore të disponueshme për këtë mbrojtje, nxitjen e respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, duke përdorur mjetet e informimit publik;

- Rritjen e rekomandimeve të drejtuara institucioneve të administratës shtetërore, me qëllim trajtimin e barabartë dhe pa diskriminim të grupeve shoqërore;

- Angazhimin, propozimin e ndryshimeve në ligjin nr. 10 221, datë 4.2.2010, "Për mbrojtjen nga diskriminimi", të ndryshuar, dhe pjesëmarrjen aktive të KMD-së në diskutimin në Kuvend të ndryshimeve, duke kontribuar në përmirësime thelbësore të ligjit dhe krijimin e një kuadri ligjor, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe rekomandimet e institucioneve monitoruese, në drejtim të mbrojtjes nga diskriminimi;

- Forcimin e bashkëpunimit me aktorët e shoqërisë civile që kontribuojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave dhe lirive themelore;

- Rritjen e aktivitetit ndërgjegjësues të zyrave rajonale për të drejtën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Kuvendi i Shqipërisë kërkon që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për vitin 2021, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të hartojë një plan masash për njohjen dhe zbatimin sa më të mirë nga subjektet publike, private dhe shtetasit të risive në ligj, të miratuara në vitin 2020, si dhe për rritjen e kapaciteteve të institucioneve dhe subjekteve private për parandalimin dhe luftimin e formave të reja të diskriminimit.

2. Të informojë në kohë Kuvendin e Shqipërisë, komisionet parlamentare përkatëse për zbatimin e rekomandimeve dhe rasteve kur KMD-ja nuk informohet për masat e marra nga subjektet për zbatimin e tyre.

3. Të rrisë angazhimin e tij në monitorimin e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të komunitetit LGBTI në fusha të tilla si: aksesi në kujdesin shëndetësor, arsim, drejtësi, punësim, strehim, si dhe të raportojë në Kuvendin e Shqipërisë për rekomandimet e adresuara dhe shkallën e zbatimit të tyre nga subjektet publike dhe private.

4. Të kontribuojë në raportin përfundimtar të Planit Kombëtar të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara 2016–2020, si një nga institucionet përgjegjëse për monitorimin e këtij plani.

5. Të shqyrtojë në kohë ankesat e adresuara dhe, nëse do të ketë çështje të mbartura nga viti i kaluar, të përfshijë në raportin vjetor arsyen e mbartjes së këtyre çështjeve.

6. Të realizojë vendimmarrje të bazuara në arsyetim të plotë të vendimeve, me qëllim kuptimin dhe zbatimin e drejtë të tyre nga subjektet. Raporti vjetor të përmbajë informacion për arsyet e shfuqizimit të vendimeve të KMD-së nga gjykatat.

7. Të vijojë të forcojë bashkëpunimin me Avokatin e Popullit dhe organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë, me qëllim rritjen e efektivitetit të trajtimit të rasteve të diskriminimit dhe të krimeve me motive urrejtje dhe të përfshijë në raportin vjetor rezultatet konkrete nga Marrëveshja e Bashkëpunimit e nënshkruar me Avokatin e Popullit dhe nga bashkëpunimi me organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

8. Të rrisë aktivitetin ndërgjegjësues përmes përdorimit të medies dhe formave të reja të komunikimit virtual, me qëllim nxitjen e respektimit të parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe informimin për rolin e KMD-së, sidomos në fushat më të përhapura të diskriminimit dhe për grupet më të diskriminuara. Një vëmendje të veçantë duhet t'u kushtojë veprimtarive ndërgjegjësuese dhe informuese të shtetasve në zonat rurale dhe në bashkitë ku KMD-ja nuk ka zyra vendore.

9. Të publikojë statistika periodike për veprimtarinë e zyrave vendore të KMD-së dhe të informojë në mënyrë periodike Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut për natyrën e problemeve të konstatuara në nivel vendor. Veprimtaritë e zyrave vendore të KMD-së dhe problemet e konstatuara të paraqiten si një rubrikë e veçantë në raportin vjetor.

10. Raporti vjetor të përmbajë kontributin e KMD-së, në lidhje me konstatimet dhe rekomandimet në progresraportin e BE-së për Shqipërinë, si dhe për ecurinë e procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me direktivat evropiane, në kuadër të procesit *screening*.

11. Në funksion të transparencës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të publikojë në faqen e tij zyrtare vendimet e formës së prerë,

burimin e financimit, fondet dhe donacionet, të dhëna konkrete për përdorimin e fondeve të përfituara, vlerën e gjobave të vendosura dhe të derdhura në buxhetin e shtetit.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.6.2021.

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT PËR VITIN 2020

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin e Autoritetit, në përmbushje të misionit të tij, për dhënien e informacionit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, në mënyrë që të edukojë publikun e të mbështesë vlerat demokratike të drejtësisë, të vërtetën, pajtimin e përgjegjësinë për brezat e ardhshëm;

Duke konsideruar se veprimtaria e Autoritetit është udhëhequr nga parimi i ligjshmërisë, mbrojtjes së të dhënave personale, dhënies së informacionit publikut, institucioneve dhe medies në kohë dhe me cilësi;

Duke vlerësuar bashkëpunimin e Autoritetit me institucione të tjera vendase dhe institucione homologe ndërkombëtare për shkëmbimin e informacionit e të përvojës, lidhur me objektin e punës së Autoritetit,

Shqyrtoi veprimtarinë e Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për vitin 2020 dhe konstaton se:

- Ka përmbushur me sukses dhe brenda afateve të kërkuara procedurat për vlerësimin e cilësive etike, morale dhe profesionale të kandidatëve për t'u zgjedhur në organet e reja të vetingut dhe në institucionet e tjera, të cilat kanë paraqitur kërkesa;

- Ka vijuar të hulumtojë në materiale arkivore duke prodhuar artikuj shkencorë, mediatikë, filma dhe dokumentarë specialë dhe ekskluzivë;

- Është angazhuar në bashkëpunimin me institucione partnere, organizata ose individë për të rritur ndërgjegjësimin, për krimet e komunizmit dhe inkurajimin e dialogut me universitetet dhe akademikët;

- Ka vijuar rishikimin e urdhrave të brendshëm, me qëllim garantimin e sigurisë për informacionin e klasifikuar që përpunohet dhe administrohet nga Autoriteti;

- Ka luajtur rol proaktiv duke mbështetur kërkimin shkencor gjatë rishqyrtimit historik të veprimtarisë së ish-Sigurimit të Shtetit, nëpërmjet garantimit të mundësisë për shqyrtimin e dokumenteve dhe dorëzimin e dublikatave të dokumenteve.

Kuvendi rekomandon që Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, për vitin 2021, të përmirësojë punën në këto drejtime:

- Të vijojë të bashkëpunojë dhe të bashkërendojë punën me institucionet qendrore dhe vendore në Republikën e Shqipërisë për identifikimin dhe rikuperimin e trupave të atyre që u zhdukën ose u ekzekutuan gjatë komunizmit, si dhe për të mbrojtur dhe ruajtur në mënyrën më të përshtatshme vendet që janë aktualisht ose do të identifikohen si vendvarrime;

- Të marrë masa konkrete për përmirësimin dhe përshpejtimin e procesit të punës për trajtimin brenda afateve ligjore të kërkesave individuale, institucionale dhe studimore, si dhe kryerjen me cilësi të detyrave që i ngarkon ligji;

- Të ndërtojë një sistem të sigurt teknologjik të shërbimit të të dhënave, sipas standardeve ndërkombëtare, që lehtëson kërkimin, gjurmimin dhe studimin e informacionit arkivor;

- Të intensifikojë përpjekjet për zgjidhjen e problematikës së krijuar për dorëzimin e dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga Arkivi i Sistemit të Ministrisë së Brendshme në respektim të zbatimit të marrëveshjes së përbashkët dhe të përfundojë procesi i marrjes në dorëzim i të gjitha dokumenteve të ish-Sigurimit të Shtetit nga institucionet arkivore në vend, në përmbushje të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit për vitin 2019;

- Të rishikojë faqen zyrtare *online*, me qëllim që informacioni të jetë lehtësisht i aksesueshëm, i saktë dhe i plotë, për aq sa e lejon ligji, në funksion të mbrojtjes së të dhënave personale, interesit publik dhe sigurisë kombëtare;

- Të bëjë transparencën e vendimmarrjes në raportimin vjetor, ku të pasqyrohet mendimi kundër në rastet e vendimmarrjes jounanime.

- Të përfshijë në raportimin vjetor të ardhurat nga shërbimet ndaj institucioneve dhe personave të tretë;

- Të intensifikojë marrëdhëniet me institucionet homologe të vendeve ish-komuniste, si një mënyrë efikase për t'u njohur dhe përfituar nga përvoja e tyre në përmbushjen e misionit të Autoritetit;

- Të vazhdojë aktivitetet në kuadër të edukimit qytetar dhe kërkimit shkencor, duke angazhuar grupet e interesit dhe përfshirë të rinjtë në aktivitetet për rishikimin e historisë dhe vënien në vend të dinjitetit njerëzor të personave që e vuajtën regjimin totalitar dhe të zhdukurve në komunizëm.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 3.6.2021.

DEKRET
Nr. 13089, datë 7.6.2021

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Hassan Mohamed Abdelzaher Shahin
2. Tasnim Hamdi Taha Abdelrehim
3. Amal Mohamed Abdelzaher Shahin Mohamed

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 13090, datë 7.6.2021

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c" dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Alda Lefter Shabanaj
2. Apostol (Apostolos) Dhimitër Ristani (Ristanis)
3. Florida Kasem Dervishi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIM
Nr. 319, datë 2.6.2021

PËR CAKTIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË TIRANËS "NËNË TEREZA", SI AEROPORT REZERVË I FORCAVE TË ARMATOSURA, GJATË GJENDJEVE PËR TË CILAT KËRKOHET MARRJA E MASAVE TË JASHTËZAKONSHME

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "i", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Caktimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës "Nënë Tereza", si aeroport rezervë i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, gjatë gjendjeve për të cilat kërkohet marrja e masave të jashtëzakonshme.

2. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 324, datë 2.6.2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 230, DATË 17.4.2019, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR SHPALLJEN, KATEGORIZIMIN DHE EMËRTIMIN E PORTIT TË LLOJIT MBM, NË PORTO-ROMANO, DURRËS, 'PORT I HAPUR PËR TRAFIK NDËRKOMBËTAR'"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, "Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 230, datë 17.4.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo në përmbajtje të vendimit, pas fjalëve "... ligji nr. 104/2015 ..." shtohet fjala " ... i ndryshuar ..." dhe pas fjalëve " ... marrëveshjes koncesionare …" shtohet fjala "... e ndryshuar ...".

2. Shkronjat "a" dhe "b", të pikës 1, ndryshohen, si më poshtë vijon:

a) Koordinatat gjeografike	Pika A: N- 41° 22'18.532" Pika B: N- 41° 21'48.277" Pika C: N- 41° 21'36.625" Pika D: N- 41° 22'6.877" Pika P1: N- 41° 22'32.520" Pika P2: N- 41° 22'25.07148" Pika P3: N- 41° 22'33.29830" Pika P4: N- 41° 21'49.92000" Pika P5: N- 41° 22'50.48000" Pika P6: N- 41° 22'15.47132" Pika P7: N- 41° 22'08.19861" Pika P8: N- 41° 22'07.89630" Pika P9: N- 41° 22'09.16808" Pika P10: N- 41° 22'12.34902" Pika Pl1: N- 41° 22'16.33018"	E- 19° 23'31.052" E- 19° 23'46.517" E- 19° 23'6.361" E- 19° 22'50.891" E- 19° 25'19.200" E- 19° 24'49.41114" E- 19° 25'18.43707 E- 19° 24'32.30000" E- 19° 24'35.27000" E- 19° 25'06.45369" E- 19° 24'47.41062" E- 19° 24'43.12646" E- 19° 24'38.71361" E-19° 24'34.95584" E- 19° 24'33.96351"
b) Veprimtaria detare	Ngarkim-shkarkim i mjeteve lundruese që transportojnë naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre, si dhe mallra të tjera, në përputhje me parashikimet e marrëveshjes koncesionare, të ndryshuar, të miratuar me ligjin nr. 104/2015, të ndryshuar.	

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 325, datë 2.6.2021

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT/PARTNERITETIT PUBLIK PRIVAT, PËR DHËNIEN ME KONCESION/PPP PËR PROJEKTIMIN, NDËRTIMIN, OPERIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E AEROPORTIT NDËRKOMBËTAR TË VLORËS (VIA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kontratës së koncesionit /partneritetit publik privat ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë *Mabco Constructions Sa, Yda Insaat Sanayi Ve Ticaret Anonim Sirketi,* 2A Group sh.p.k., si koncesionari për dhënien me koncesion/PPP për projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës (VIA), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 327, datë 2.6.2021

PËR MEKANIZMIN E BASHKËRENDIMIT TË PUNËS NDËRMJET AUTORITETEVE PËRGJEGJËSE, PËR REFERIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË MARRËDHËNIET FAMILJARE, SI DHE PROCEDIMIN E TIJ, PËR MBËSHTETJEN E REHABILITIMIN E VIKTIMAVE TË DHUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 8, të nenit 8, të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim rregullon procedurat standarde bazë për bashkërendimin e punës ndërmjet autoriteteve përgjegjëse, për parandalimin e dhunës në familje, për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave të të gjitha formave të dhunës në familje, duke garantuar të drejtat e njeriut e promovuar barazinë gjinore, si edhe eliminuar të gjitha format e diskriminimit ndaj grave.

2. Në këtë vendim, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "**Koordinator vendor për referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare"**, punonjësi pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, përgjegjës për referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave;

b) "**Menaxhim i rastit të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave**", veprimtaria efektive që siguron ndihmën e mbështetjen e personave të dhunuar në marrëdhëniet familjare, me qëllim mbrojtjen, garantimin e të drejtave dhe rehabilitimin e tyre;

c) "**Rast urgjent**", rasti kur dhuna e ushtruar paraqet nivel të lartë të rrezikut për jetën, shëndetin, mirëqenien dhe lirinë e personit dhe merren masa paraprake të menjëhershme për mbrojtjen e viktimave, për ndalimin e dhunës dhe përshkallëzimin e mëtejshëm të saj;

ç) "**Shporta e shërbimeve**", tërësia e shërbimeve që ofrohen nga njësia vendore për mbrojtjen urgjente dhe afatgjatë të viktimës;

d) "**Riviktimizim**", shkaktimi në mënyrë të përsëritur i dëmtimeve të mëtejshme viktimës së dhunës në familje nga ana e dhunuesit, si pasojë e një veprimi që ka lidhje me raportimin/denoncimin e dhunës;

dh) "**Viktimizimi dytësor**", shkaktimi i një gjendjeje, që rëndon më tej dëmin që viktima e dhunës ka pësuar për shkak të pjesëmarrjes në procedura ligjore, si rezultat i raportimit dhe/ose pjesëmarrjes në procesin e drejtësisë;

e) "**REVALB**", sistemi elektronik i regjistrimit dhe i ruajtjes së të dhënave për rastet e dhunës në familje pranë njësisë vendore.

II. BASHKËRENDIMI I INSTITUCIONEVE PËR MENAXHIMIN E RASTEVE TË DHUNËS NË FAMILJE

1. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje krijohet pranë çdo bashkie dhe ka për qëllim parandalimin dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.

2. Mekanizmi i koordinuar i referimit të rasteve të dhunës në familje përbëhet nga:

a) komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;

b) ekipet teknike ndërdisiplinore (në vijim, ETN);

c) koordinatorët vendorë (në vijim, KV).

3. Këshilli bashkiak, me propozimin e kryetarit të bashkisë, përcakton numrin e KV-ve dhe përbërjen e njësisë kundër dhunës në familje. Për këtë vendimmarrje merret në konsideratë numri i popullsisë së bashkisë dhe numri i rasteve të dhunës në familje, sipas statistikave në dispozicion. Këshilli bashkiak siguron që:

a) në bashkitë e mëdha me mbi 200 000 (dyqind mijë) banorë krijohet një njësi kundër dhunës në familje e përbërë nga jo më pak se 2 (dy) koordinatorë vendorë me kohë të plotë, që bashkëpunojnë me nga një administrator shoqëror/punonjës social, për çdo njësi administrative;

b) në bashkitë e mesme dhe të vogla njësia kundër dhunës në familje përbëhet nga një KV me kohë të plotë, që bashkëpunon me nga një administrator shoqëror/punonjës social, për çdo njësi administrative.

4. Veprimtaria e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje mbështetet e udhëhiqet nga këto parime:

a) shërbime të aksesueshme lehtë dhe të arritshme;

b) trajtimi me respekt e dinjitet i viktimave;

c) ndalimi i viktimizimit, riviktimizimit dhe viktimizimit dytësor;

ç) konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale;

d) siguria e jetës dhe e shëndetit;

dh) ndalimi i diskriminimit;

e) trajtimi efektiv dhe përkujdesja individuale;

ë) mbështetja dhe partneriteti.

5. Komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje funksionojnë pranë çdo bashkie.

6. Komiteti drejtues kryesohet nga kryetari i bashkisë dhe ka në përbërje:

a) përfaqësuesin e strukturës së Policisë së Shtetit;

b) përfaqësuesin e drejtorisë arsimore;

c) përfaqësuesin e Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor;

ç) drejtuesin e strukturës për shërbimet sociale pranë bashkisë;

d) përfaqësuesin e strukturës për shërbimet sociale në bashki ose qark;

dh) përfaqësuesin e prefektit të qarkut;

e) kryetarin e qarkut në territorin administrativ që ka për qendër atë bashki;

ë) përfaqësuesin e zyrës përkatëse të punësimit;

f) drejtuesit e organizatave jofitimprurëse, të cilat janë të specializuara dhe punojnë në fushën e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje;

g) drejtuesit e qendrave/strehëzave të ngritura për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në atë bashki ose në qarkun në juridiksionin e të cilit janë këto njësi, si dhe qendrave të rehabilitimit për dhunuesit;

gj) përfaqësues të institucioneve fetare, që mund të ofrojnë shërbime për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare;

h) drejtuesin e Dhomës së Avokatisë së rrethit dhe përfaqësuesin e Drejtorisë së Ndihmës Juridike;

i) KV-në, i cili, për rastet kur bashkia ka 2 (dy) të tillë, caktohet nga kryetari i bashkisë.

7. Përbërja e anëtarëve të komitetit drejtues, sipas përbërjes së përcaktuar në pikën 6, të këtij kreu, zbatohet, për aq sa dhe është e mundur, duke mbajtur në vëmendje strukturat që gjenden në atë bashki.

8. Sipas rastit, në varësi të rendit të ditës, në mbledhjet e komitetit drejtues, mund të ftohen edhe përfaqësues nga:

a) gjykata e rrethit gjyqësor;

b) prokuroria e rrethit;

c) zyra e përmbarimit;

ç) Qendra e Menaxhimit të Dhunës Seksuale;

d) Shërbimi i Provës;

dh) Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve;

e) Urdhri i Psikologut;

ë) Urdhri i Punonjësit Social;

f) kryetari i fshatit;

g) mjekësia ligjore;

gj) mediet lokale;

h) autoritetet apo shërbimet e tjera në nivel vendor me rëndësi për pjesëmarrje nisur nga çështjet e rendit të ditës;

i) çdo specialist që konsiderohet me rëndësi për marrjen e vendimeve të komitetit drejtues.

9. Përfaqësuesit në komitetin drejtues janë në nivel drejtuesish, nëse pranë bashkive, ku këto komitete ngrihen, funksionojnë institucione të sistemit të drejtësisë, të strukturave arsimore, shëndetësore dhe të punësimit. Nëse pranë bashkive nuk funksionojnë institucionet e sipërpërmendura, institucionet që funksionojnë në qendrën e prefekturës dërgojnë përfaqësues të tyre në komitetet e këtyre bashkive.

10. Përzgjedhja e drejtuesve të organizatave jofitimprurëse bëhet nga kryetari i bashkisë në bashkëpunim me drejtuesin e strukturës së shërbimeve sociale të kësaj njësie të

vetëqeverisjes vendore, në përfundim të një procedure aplikimi të hapur duke pasur në vëmendje, por pa u kufizuar në rolin dhe veprimtarinë e OJF-ve në çështje të dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore, diskriminimit, mbrojtjes së të drejtave të pakicave kombëtare ose fusha të ngjashme.

11. Komiteti drejtues mblidhet së paku një herë në tre muaj në mbledhje të zakonshme dhe sipas nevojave në mbledhje të jashtëzakonshme. Të drejtën për të kërkuar mbledhjen e komitetit drejtues dhe përfshirjen e çështjeve në rendin e ditës, si dhe të ftuarve sipas pikës 8, të këtij kreu, e kanë kryetari i bashkisë ose jo më pak se tre anëtarë.

12. Njoftimi për mbledhjen e zakonshme bëhet me shkrim, përfshirë këtu dhe dërgimin në adresën elektronike, të paktën 10 (dhjetë) ditë përpara datës së mbledhjes. Në rastin e mbledhjeve të jashtëzakonshme njoftimi bëhet të paktën 24 (njëzet e katër) orë përpara. Në çdo rast, njoftimi për mbledhjen e komitetit drejtues përmban datën, orën, vendin dhe detaje për rendin e ditës. Vendimet e komitetit drejtues me rëndësi për publikun publikohen në faqen *web* të secilës njësi të vetëqeverisjes vendore.

13. Pjesëmarrja e anëtarëve të komitetit drejtues në mbledhjet e tij është e detyrueshme. Në rastet kur njëri nga anëtarët e komiteti drejtues nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, mungesa duhet të justifikohet me anë të një njoftimi me shkrim, në mënyrë elektronike dhe në formë shkresore. Në këtë rast, titullari i institucionit përkatës cakton një zëvendësues për të marrë pjesë në atë mbledhje të komitetit drejtues. Mungesa e pajustifikuar në më shumë se dy mbledhje radhazi sjell zëvendësimin e anëtarit.

14. Komiteti drejtues, në veprimtarinë e tij:

a) ndjek zbatimin e detyrimeve dhe të politikave që burojnë nga ligji për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, për organet e vetëqeverisjes vendore përfshirë, por pa u kufizuar në detyrimet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për nevojat specifike të viktimave;

b) ndjek identifikimin e problemeve për dhunën në familje dhe zbatimin e ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare në territorin e të bashkisë/qarkut, brenda të cilit ushtrojnë kompetencat anëtarët e tij;

c) analizon efektet financiare në menaxhimin e rasteve dhe kostot e tjera të shportës e shërbimeve për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës, për të siguruar mbështetjen me shërbime të specializuara emergjente, rehabilituese (afatmesme) dhe riintegruese (afatgjata) mbi bazën e të cilave çdo institucion bën buxhetimin e përgjithshëm gjinor në varësi të funksioneve e të përgjegjësive që ka secili anëtar i komitetit drejtues;

ç) kujdeset për ndërgjegjësimin dhe orienton organizimin e fushatave e takimeve ndërgjegjësuese kundër dhunës në familje e dhunës ndaj grave, si dhe në publikimin e materialeve ndërgjegjësuese dhe informuese;

d) ndjek identifikimin e çështjeve që lidhen me menaxhimin e rasteve të dhunës në familje përmes të dhënave të gjeneruara nga sistemi REVALB, si dhe përditësohet me të dhënat nga ky sistem;

dh) bën propozime dhe kërkesa konkrete, të cilat u drejtohen autoriteteve shtetërore përgjegjëse në nivel qendror e vendor për mënyrën e zgjidhjes së problematikave në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave dhe vajzave në përgjithësi dhe me fokus të veçantë gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara, grave të minoriteteve, të grave nga komuniteti LGBTI, grave të moshës së tretë, të vajzave nëna dhe nënave kryefamiljare, grave të zonave rurale, shtetasve të huaj dhe atyre pa shtetësi sipas ligjit në fuqi për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, duke ndikuar në zgjidhje përmes kapaciteteve dhe shërbimeve specifike për të adresuar nevojat e grupeve të ndryshme të grave, të cilat pësojnë diskriminim të shumëfishtë;

e) bën vlerësimin e punës së ekipit teknik ndërdisiplinor mbështetur në informacionet dhe raportet periodike të paraqitura nga ky ekip për çdo rast, si dhe marrjen e vendimeve për përmirësimin e funksionimit të tij;

ë) miraton në parim marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të ligjit në fuqi, për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare;

f) kujdeset për rritjen profesionale të anëtarëve të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe organizimin e trajnimeve të përbashkëta

ndërdisiplinore të personelit në varësi të tyre, që ndjekin çështjet e dhunës në marrëdhëniet familjare, si dhe sigurimin për njohjen e qytetarëve me funksionet e mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe me mënyrat e kontaktimit të tyre;

g) nxit aktivizimin e individëve, të shoqërisë civile dhe të përfaqësuesve të njësive administrative drejt bashkëpunimit dhe referimit të rasteve, duke garantuar fshehtësinë e të dhënave personale të viktimave të dhunës dhe të profesionistëve apo institucioneve /organizatave, të cilat ofrojnë informacion për rastet;

gj) miraton rregulla për procedurat e funksionimit të ETN-së dhe protokollin e menaxhimit të rasteve.

15. Çdo anëtar i komitetit drejtues është i detyruar të informojë me shkrim titullarin e institucionit përkatës, si dhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse për vendimet ose masat e marra nga komiteti drejtues, me qëllim marrjen në kohë të masave që lidhen me veprimtarinë e asaj strukture.

16. Komiteti drejtues në marrëdhëniet me organet e pushtetit qendror dhe vendor përfaqësohet nga kryetari i bashkisë.

17. Komiteti drejtues për veprimtarinë e tij i raporton çdo tre muaj ministrit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje.

Pjesë e raportimit janë të dhënat e problemet e evidentuara për dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave, në territorin ku komiteti drejtues shtrin juridiksionin e vet, duke paraqitur sipas rastit edhe propozime konkrete për mbështetjen që kërkohet nga autoriteti kryesor përgjegjës ose/dhe autoritetet e tjera të linjës.

18. Komiteti drejtues, sipas problematikës së evidentuar, vë në dijeni, për sa më sipër, njërin prej ose të gjitha autoritetet përgjegjëse të linjës sipas parashikimeve të ligjit në fuqi për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare. Një kopje e raportit i vihet në dispozicion këshillit bashkiak dhe këshillit të qarkut.

19. Përfaqësuesit e autoriteteve të tjera shtetërore në nivel vendor, të cilët janë anëtarë të komitetit drejtues, raportojnë çdo tre muaj në institucionet e tyre qendrore për veprimtarinë e tyre në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje. Në raportimet periodike që paraqiten, komiteti drejtues kujdeset që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave.

20. Ekipi teknik ndërdisiplinor ngrihet me vendim të komitetit drejtues me qëllim bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe drejtohet nga KV-ja.

21. ETN-ja përbëhet nga përfaqësues teknikë të institucioneve që janë të përfaqësuara në komitetin drejtues, përfaqësues nga prefektura përkatëse, nga Shërbimi i Provës, nga Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe nëpunës vendorë të barazisë gjinore, pranë asaj njësie të vetëqeverisjes vendore, si dhe nga profesionistë të lirë nga fushat sociale, të psikologjisë, avokatisë, të shërbimit shëndetësor, të mjekësisë ligjore, përmbarimit dhe Shërbimit të Ndihmës Juridike Falas.

22. Përfaqësuesit e institucioneve, që janë anëtarë të ETN-së, kanë mandat dyvjeçar me të drejtë ripërtëritje, i cili mund të ndërpritet vetëm në rastin e transferimit në një detyrë tjetër.

23. ETN-ja mblidhet në mbledhje të zakonshme çdo muaj dhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë që lind nevoja për raste konkrete të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave.

24. ETN-ja, në bashkëpunim me grupin teknik ndërdisiplinor për të drejtat e fëmijëve (GTN), organizojnë mbledhje të përbashkëta rast pas rasti, kur dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave shoqërohet edhe me dhunën ndaj fëmijëve ose kur përshihen fëmijët si dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare.

25. Punonjësi social pranë strukturave të posaçme të shërbimeve sociale në nivel vendor referon para ekipit teknik ndërdisiplinor rastet e dhunës në marrëdhëniet familjare, ku përfshihen rastet e identifikuara, rastet e referuara dhe të raportuara që kanë ndodhur në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore. Punonjësi social referon edhe rastet e identifikuara të dhunës ndaj grave që janë dhunuar jashtë marrëdhënieve familjare, kur viktima ka nevojë për shërbime mbështetëse.

26. ETN-ja ka këto detyra:

a) ndjekjen e rastit me kërkesën e personave

të interesuar ose kryesisht dhe respektimin e të drejtave të viktimave, si dhe plotësimin e nevojave të viktimave sipas dispozitave të parashikuara në kreun III, të këtij vendimi, lidhur me procedurat për menaxhimin e rastit;

b) koordinimin, ofrimin e shërbimeve përmes lidhjes së marrëveshjeve të bashkëpunimit me Shërbimin e Provës, Dhomën Kombëtare të Avokatisë, Urdhrin e Psikologut, me shërbimet komunitare, shërbimet në qendrat e zhvillimit, strehëzat, qendrat e trajtimit të emergjencave dhe të ngjashme me to, që ushtrojnë veprimtarinë brenda territorit të administrimit vendor. Në këto marrëveshje përcaktohet roli dhe detyrimet institucionale për parandalimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, si dhe për zgjidhjen e pasojave, duke ofruar shërbime bazë edhe në zonat rurale e periferike;

c) bashkërendimin e punës me strukturat përkatëse në komisariatet e policisë lidhur me referimin e menaxhimin e rasteve të dhunës në familje, përfshirë dhunën ndaj grave. Strukturat policore vendore janë struktura pritëse për referimet e rasteve dhe kanë në disponim linjën kombëtare për komunikim pas orës 17:00, për shkak të shërbimit 24-orësh nga ana e Policisë së Shtetit;

ç) koordinimin e ndihmës për dhunën në familje, përfshirë dhunën ndaj grave, që evidentohet në rastet e emergjencave civile dhe të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, si dhe dhunën ndaj shtetasve të huaj dhe të atyre pa shtetësi;

d) ndjekjen në bashkëpunim edhe me koordinatorët vendorë e me punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve të zbatimit të masave për eliminimin e pasojave të dhunimit të fëmijëve prej prindërve ose kujdestarëve ligjorë apo në rastin kur fëmijët jetojnë në familje, ku prindërit ose kujdestarët dhunojnë njëri-tjetrin;

dh) marrjen e masave për vendosjen e fëmijëve në përkujdesje alternative ose dhënien e masave mbrojtëse emergjente, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, kur ata vuajnë pasojat e dhunës në familje;

e) përcjelljen e raportit mujor me të dhëna për rastet konkrete KV-së si drejtues i ekipit teknik ndërdisiplinor. Të gjithë anëtarët e ETN-së kanë detyrimin të përcjellin të dhënat e përditësuara për fushën e tyre të përgjegjësive për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje çdo muaj te KV-ja që këto të reflektohen në REVALB në mënyrë sistematike;

ë) monitorimin e raportimin mujor me shkrim në komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor, dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave;

f) monitorimin e raportimin mujor me shkrim të përfaqësuesve të institucioneve në përbërje të ETN-së për titullarët e këtyre institucioneve lidhur me veprimtarinë dhe mbledhjet e ETN-së, rastet që janë referuar dhe mënyrën e menaxhimit të tyre;

g) bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse për monitorimin e ngritjes dhe të funksionimit të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore për viktimat e dhunës në familje, që ofrohen pranë njësive të vetëqeverisjes vendore;

gj) ndjekjen e zbatimit të protokolleve dhe të standardeve për vlerësimin e riskut dhe planet e ndërhyrjes në rastet e dhunës në familje.

27. Pranë çdo bashkie caktohet KV-ja, në zyra të dedikuara posaçërisht për kryerjen e këtij funksioni, i cili nuk ka në përshkrimin e punës mbivendosje me detyra të tjera.

28. KV-ja ndërton një platformë pune për parandalimin, referimin dhe menaxhimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare. Në përmbushjen e detyrave dhe të përgjegjësive të tij lehtësohet nga një ekip mbështetës për ndjekjen e rastit në terren. Në ekipin mbështetës marrin pjesë KV-ja dhe përfaqësues nga shërbimet mbështetëse brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore. Stafi mbështetës lehtëson KV-në në përballimin e ngarkesës, veçanërisht në njësitë e vetëqeverisjes vendore më të mëdha dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore që kanë më shumë raste dhune.

29. KV-së i sigurohet aksesi për informacion lidhur me shërbimet e ofruara për viktimat e dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave në çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, me qëllim ndjekjen e rastit e të historikut të tij.

30. KV-ja merr informacion:

a) përmes raporteve mujore nga shërbimet sociale të njësive përkatëse të vetëqeverisjes vendore dhe/ose organizatat që ofrojnë

shërbime, që, sipas rastit, të mbështesin me ndihmë psikosociale, shëndetësore e financiare personat e dhunuar në familje, si dhe për monitorimin e respektimit të urdhrave të mbrojtjes (në vijim, UM) nga palët;

b) nga përgjegjësit e programit të rehabilitimit për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare, për rastin kur dhunuesi është urdhëruar të marrë pjesë në programe rehabilitimi psikosociale dhe/ose në programe të aftësimit prindëror, të organizuara nga subjekte publike ose private lidhur me pjesëmarrjen e të padituri në program dhe ecurinë e tij, në mënyrë periodike, si dhe në përfundim të programit, në të cilin të përfshihen rezultatet e rehabilitimit të dhunuesit;

c) nga përgjegjësit e programit të rehabilitimit, kur i padituri dhunues është vendosur pranë qendrave spitalore, qendrave ambulatore ose qendrave komunitare, që japin shërbime të shëndetit mendor, shërbime të alkoologjisë ose shërbime të toksikologjisë për pjesëmarrjen e të padituri dhunues në program dhe ecurinë e tij.

31. KV-ja ka këto detyra:

a) drejton punën e ekipit teknik ndërdisiplinor, ndërmerr iniciativën dhe organizon takimet e këtij ekipi, si dhe informon për ecurinë e punës së tij komitetin drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje;

b) koordinon ekipin teknik ndërdisiplinor për rastet që kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme për situatat më emergjente dhe siguron burime ose shërbime reference për individët që kërkojnë strehim, asistencë ligjore falas, këshillim dhe të tjera mbështetje të nevojshme;

c) koordinon punën me GTN-në dhe raporton në mbledhjet e përbashkëta të ETN-së me GTN-në, kur dhuna në familje dhe dhuna ndaj grave shoqërohet edhe me dhunën ndaj fëmijëve ose kur përshihen fëmijët si dëshmitarë të dhunës në marrëdhëniet familjare;

ç) koordinon punën, duke bashkëpunuar me punonjësin social pranë strukturave të posaçme të shërbimeve sociale në bashki dhe administratorët shoqërorë/punonjësit social në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ku ushtron veprimtarinë;

d) koordinon punën me administratorët shoqërorë/punonjësit socialë të njësive të vetëqeverisjes vendore në rastin kur bashkitë janë të organizuara me disa njësi të tilla, duke mbuluar me shërbime edhe zonat rurale e periferike;

dh) bashkëpunon me organet ligjzbatuese për marrjen dhe zbatimin e masave për ndarjen e dhunuesit nga familja, me qëllim lënien në përdorim të banesës familjare viktimës dhe fëmijëve dhe për zbatimin e vendimit gjyqësor;

e) bashkëpunon me shërbimin e provës për monitorimin e ekzekutimit të urdhrave të mbrojtjes, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor;

ë) harton një listë të organizatave jofitimprurëse e të profesionistëve, të cilët ofrojnë shërbime falas për viktimat e dhunës (psikologjike, këshillim, shërbime mjekësore, juridike falas, strehim) dhe e përditëson atë vazhdimisht;

f) ndërmjetëson me OJF-të, Policinë e Shtetit, shërbimet shëndetësore, gjykatat, Shërbimin e Provës, strukturat e shërbimit të ndihmës juridike, shërbimet sociale dhe institucione / organizata të tjera referimi për të marrë e dhënë informacion, për t'i lidhur viktimat me shërbimet, si dhe për të siguruar vazhdimësinë e kujdesit ndaj tyre;

g) koordinon punën me qendrat sociale e të rehabilitimit për viktimat dhe ofrimin e shërbimeve për to, duke u dhënë përparësi qendrave të specializuara në fushat përkatëse e qendrave të emergjencës për trajtimin e menjëhershëm të viktimave të dhunës në familje dhe dhunës ndaj grave, si dhe me qendrat publike për trajtimin, trajnimin dhe rehabilitimin e dhunuesve;

gj) sigurohet që dosjet dhe dokumentacioni rreth viktimave të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, si dhe siguron ruajtjen e kopjeve të urdhrave të gjykatës dhe të dokumentacionit të kërkuar. Merr një kopje të urdhrit për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme dhe ndjek zbatimin e tij;

h) përditëson të dhënat për të gjitha rastet e dhunës në familje, të trajtuara nga ETN-ja në një bazë elektronike të mbajtjes së të dhënave, si dhe ndan një herë në muaj një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë

anëtarët e këtij ekipi. Për këtë qëllim, secili anëtar i ekipit ndërdisiplinor ka përgjegjësi që të përcjellë te KV-ja, një herë në muaj, informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore apo është trajtuar vetëm brenda për brenda institucionit të vet;

i) sigurohet që viktimat të marrin kërkesat për paraqitje në gjykatë, urdhrat e lëshuar nga gjykata për ndjekjen e hapave të duhur në rast shkeljeje të urdhrave të gjykatës, si dhe sigurohet që të kryhen të gjitha llojet e ndërhyrjeve të nevojshme në përputhje me ligjin;

j) asiston viktimat në njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndjekjen e procedurave të nevojshme për marrjen e një urdhri mbrojtjeje (UM)/urdhri të menjëhershëm të mbrojtjes (në vijim, UMM), si dhe për hapat që duhen ndjekur, nëse urdhri shkelet;

k) shoqëron viktimat e dhunës në gjykatë, polici dhe/ose pranë shërbimeve të tjera;

l) harton planin e përbashkët të ndërhyrjes (PPN), sikurse parashikohet në këtë vendim;

ll) monitoron, gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UMM/UM-në, respektimin e urdhrit të mbrojtjes nga palët dhe çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë përgatit një raport, për të cilin, në çdo rast, vë në dijeni Policinë e Shtetit;

m) bashkëpunon për të siguruar vizitat në banesën e viktimës sipas vendimit të gjykatës për urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes dhe/ose urdhrin e mbrojtjes, duke dhënë edhe informacionin e nevojshëm;

n) koordinon organizimin e trajnimeve të ndërmarra nga strukturat përgjegjëse, sipas ligjit nr. 47/2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006, 'Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare', të ndryshuar", për ekipin teknik ndërdisiplinor dhe personelin tjetër që punon me komunitetin;

nj) mbështet informimin e anëtarëve të komunitetit, të profesionistëve dhe organizatave jofitimprurëse rreth dhunës në familje dhe shërbimin me materiale ose botime të ndryshme sensibilizuese e ndërgjegjësuese për dhunën;

o) harton marrëveshjet e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve shtetërore për realizimin e detyrave në funksion të zbatimit të legjislacionit në fuqi për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes së bashkëpunimit tip dhe ia propozon ato komitetit drejtues për miratim në parim;

p) paraqet raporte mujore, tremujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues, për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, në formë të përmbledhur, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet e ndeshura, që mund të kërkojnë zgjidhje nga komiteti drejtues;

q) identifikon protokollet ekzistuese në komunitet ose marrëdhënie informale bashkëpunimi që janë të suksesshme;

r) propozon krijimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare në strukturën e shërbimeve sociale pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore;

rr) është anëtar i grupit që përgatit planet sociale, ku analizohen nevojat sociale dhe parashikohen masat për përmirësimin ose ngritjen e shërbimeve të reja për subjektet e përfshira në dhunën në familje, si dhe anëtar i grupit që përgatit planet vendore për barazinë gjinore në nivel vendor.

III. PROCEDURAT BAZË PËR MENAXHIMIN E RASTIT TË DHUNËS NË FAMILJE

1. Raportimi dhe identifikimi i rastit të dhunës në familje kryhet nga koordinatori vendor pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore përmes:

a) verifikimit të raportimeve nga personi i dhunuar;

b) referimit të rastit nga strukturat e Policisë së Shtetit;

c) referimit të rastit nga çdo institucion i përfaqësuar në ETN;

ç) verifikimit të raportimeve nga çdo person tjetër fizik a juridik, publik ose privat;

d) verifikimit të njoftimeve nga media e shkruar, elektronike ose mediat sociale.

1.1 KV-ja raporton e identifikon edhe rastet e tjera të dhunës së ushtruar ndaj grave, të parashikuara në Konventën e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër

dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", sipas kësaj pike.

2. Viktima e dhunës dhe/ose çdo person fizik a juridik, publik ose privat, që konstaton një rast të ushtrimit të dhunës, raporton rastin pranë KV-së, Policisë së Shtetit ose çdo institucioni anëtar të ETN-së. Pavarësisht se në cilin prej institucioneve të ETN-së raportohet rasti i dhunës, secili prej tyre, nëse konstaton se ka nevojë për ndërhyrje, njofton KV-në, i cili merr masat e nevojshme për vlerësimin e nevojave dhe trajtimin e rastit.

3. Vlerësimi dhe menaxhimi i riskut për rastet e dhunës në familje realizohet nga Policia e Shtetit në bashkëpunim me KV-në e bashkisë përkatëse, të cilët e kryejnë këtë proces sipas udhëzimeve të përbashkëta të ministrit të Brendshëm dhe ministrit përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, për procedurat e vlerësimit të riskut dhe lëshimin e Urdhrit për Masat Paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme (UMPMM).

4. Kur nga vlerësimi i riskut rezulton se rasti është urgjent, struktura përgjegjëse e Policisë së Shtetit lëshon menjëherë UMPMM-në dhe, në bashkëpunim me KV-në, merr masat mbrojtëse të përshtatshme për zbatimin e tij.

5. Koordinimi i masave mbrojtëse të menjëhershme realizohet, si më poshtë vijon:

a) koordinatori vendor bashkërendon veprimet në rastin urgjent, për zbatimin e UMPMM-së të lëshuar nga Policia e Shtetit dhe/ose UMM-së të lëshuar nga gjykata;

b) Policia e Shtetit, në bashkëpunim me KV-në, dhe, nëse është rasti, me përfaqësuesin e zyrës së përmbarimit, marrin masa për largimin e dhunuesit nga banesa;

c) KV-ja përcakton me urgjencë nevojat për shërbime të specializuara dhe burimet përkatëse;

ç) KV-ja, në bashkëpunim me përfaqësuesin e Drejtorisë Qendrore të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (DQOSHKSH në ETN), kryejnë shoqërimin e viktimës në institucionet e shëndetit parësor;

d) kur viktima e dhunës në familje dhe fëmijët nuk janë të sigurt në shtëpi, KV-ja, në bashkëpunim me Policinë e Shtetit dhe përfaqësuesin e Zyrës së Përmbarimit në ETN, me pëlqimin e saj, kryejnë shoqërimin dhe transportimin e viktimës në një vend të sigurt, strehëza, në një banesë sociale a vendbanim tjetër;

dh) në rastin kur viktima shoqërohet nga fëmijët e mitur, shoqërimi në strehëza kryhet mbi bazën e përcaktimeve të UMPMM-së në bashkëpunim me NJMF-në;

e) KV-ja bashkëpunon me subjektet publike ose private që ofrojnë ndihmë ligjore për ofrimin e këshillimeve dhe ndihmës ligjore falas, për lëshimin e urdhrave gjyqësorë të mbrojtjes, si dhe nevojave të tjera për të cilat paraqitet rasti;

ë) KV-ja bashkëpunon me qendrat që ofrojnë këshillim psikologjik, shërbime shëndetësore dhe mbështetje të tjera të nevojshme, të cilat parashikohen në protokollin përkatës të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje;

f) nëse nga vlerësimi i riskut rezulton viktima e dhunuar seksualisht, KV-ja, së bashku me strukturën përgjegjëse të Policisë së Shtetit, dërgojnë menjëherë viktimën në një qendër të menaxhimit të krizës për rastet e dhunës seksuale;

g) Në të gjitha rastet që nevojiten shërbime të tjera, KV-ja, në bashkëpunim me anëtarët e ETN-së, referojnë e shoqërojnë viktimën pranë subjekteve publike ose private që ofrojnë shërbimet përkatëse, siç është parashikuar në protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje ose në protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës seksuale;

gj) KV-ja bashkëpunon me Policinë e Shtetit dhe autoritetet e tjera përgjegjëse sipas detyrave që përcakton ligji në fuqi kundër dhunës në marrëdhëniet familjare dhe procedurës së parashikuar në këtë vendim;

h) kur dhuna është ushtruar ndaj një fëmije ose në prani të fëmijëve, KV-ja bashkëpunon me njësinë përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve për marrjen e masave të nevojshme për mbrojtjen e fëmijës. Në këtë rast zbatohen masat sipas legjislacionit në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të atij kundër dhunës në marrëdhëniet familjare;

i) gjatë kohëzgjatjes së UMM-së, KV-ja monitoron respektimin e masave që urdhërohen për palën e paditur. Nëse nga monitorimi konstatojnë veprime të kryera nga i padituri që janë në kundërshtim me këtë urdhër, KV-ja njofton menjëherë Policinë e Shtetit.

6. Koordinimi i masave mbrojtëse afatgjata kryhet, si më poshtë vijon:

a) pas dhënies së ndihmës së parë me masat mbrojtëse të menjëhershme, KV-ja dhe anëtarët e ETN-së hartojnë planin e përbashkët të ndërhyrjes (PPN) për zgjidhjen afatgjatë të rastit të trajtuar, duke u bazuar edhe në masat mbrojtëse të vendosura nga UM-ja e lëshuar me vendim gjykate;

b) si rregull, PPN-ja parashikon:

i. masat konkrete për të ulur nivelin e rrezikut dhe parandaluar përsëritjen e dhunës;

ii. shërbimet e nevojshme për të përmbushur nevojat e viktimës së dhunës, në mënyrë të veçantë nevojat për strehim, punësim, ndihmë juridike të garantuar nga shteti;

iii. shërbimet dhe ndihmën e nevojshme për rehabilitimin e viktimës;

iv. ndihmën dhe mbështetjen e viktimës për lëshimin e UMM-së dhe/ose UM-së;

v. ndihmën dhe mbështetjen për rehabilitimin e dhunuesit, nëse kjo është parashikuar në UMM-në/UM-në e lëshuar me vendimin e gjykatës;

vi. afatet kohore;

vii. autoritetet përgjegjëse;

viii. institucionet, organizatat ose individët që do të ofrojnë shërbimet publike dhe jopublike.

7. KV-ja mban një dosje dhe u dërgon anëtarëve përkatës të ETN-së raportin e referimit të rastit me të dhënat shoqëruese për viktimën e dhunës në familje, analizën e riskut, urdhrin e mbrojtjes që është lëshuar, si dhe dokumente të tjera bashkëshoqëruese, duke caktuar detyrat për secilin prej tyre, afatet përkatëse, si dhe shërbimet që kanë nevojë të mbulohen me shpenzime.

8. KV-ja i paraqet, për miratim, drejtorit të strukturës përkatëse për shërbimet shoqërore në bashki, PPN-në, së bashku me analizën e riskut. Drejtori, pasi vlerëson shpenzimet që nevojiten, brenda së njëjtës ditë, miraton PPN-në dhe merr masat për prokurimin e shërbimeve që kërkojnë shpenzime. Në pamundësi financiare, drejtori orienton kryerjen e shërbimeve në mënyrë progresive në varësi të shtimit të fondeve ose kërkon bashkëpunimin e anëtarëve të tjerë të ETN-së për përmbushjen e shërbimeve. KV-ja u dërgon zyrtarisht të gjithë anëtarëve të ETN-së që do të mbështesin rastin PPN-në përfundimtare ditë e nesërme.

9. Koordinimi i masave mbrojtëse të menjëhershme, si dhe i masave të koordinuara nga PPN-ja mund të zbatohen edhe për mbështetjen e viktimave të dhunës ndaj grave që dhunohen jashtë marrëdhënieve familjare.

10. Viktimat në moshë të mitur trajtohen në bashkëpunim me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë njësisë vendore përkatëse.

11. Viktimat e trafikimit dhe të shfrytëzimit për prostitucion referohen nga KV-ja pranë Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave.

12. Në rastet kur në të gjithë vendin ose në njësinë e vetëqeverisjes vendore janë shpallur masat e jashtëzakonshme, do të ndiqen procedurat e posaçme të menaxhimit të rasteve të miratuara nga autoriteti kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare.

13. Administrimi dhe raportimi i të dhënave realizohet, si më poshtë vijon:

a) KV-ja, në bashkëpunim me të gjithë anëtarët e ETN-së që kanë menaxhuar rastin, dokumenton:

i. të dhënat për informacionin, veprimet e kryera, shërbimet e ofruara dhe rezultatet e arritura gjatë procesit të menaxhimit të rastit të dhunës në familje;

ii. të dhënat për dhunuesin që ka ushtruar dhunë ndaj viktimave të dhunës në familje;

iii. të dhënat për fëmijët që kanë pësuar dhunë, si dhe për viktimat e dhunës seksuale në familje;

iv. të dhënat për të gjitha llojet e mbrojtjes dhe trajtimit deri në rehabilitimin e viktimës si dhe gjurmimin e monitorimit të ekzekutimit të tyre;

b) këto të dhëna regjistrohen dhe përditësohen nga KV-ja, përpunohen dhe administrohen prej tij në sistemin elektronik të ruajtjes së të dhënave pranë bashkisë www.revalb.org, në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet nënligjore përkatëse. Për sa është e mundur, dokumentohen edhe të dhënat për mbështetjen e viktimave të dhunës ndaj grave, që dhunohen jashtë marrëdhënieve familjare;

c) sistemi REVALB përfshin hedhjen e

përditësimin e të dhënave statistikore të rasteve të dhunës në familje, veprimet e kryera, shërbimet e ofruara, si dhe të elementeve që kanë lidhje me monitorimin e funksionimit të mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje. Ai ka qëllim:

i. mbledhjen e të dhënave dhe sistemimin e tyre, si dhe ndjekjen e tyre në kohë reale;

ii. koordinimin e përpjekjeve ndërinstitucionale, në mënyrë që të mundësohet ofrimi i zgjidhjeve të menjëhershme për rastet e dhunës në familje;

iii. unifikimin dhe kompjuterizimin e mbledhjes së të dhënave, me qëllim krijimin e një baze statistikore që ndihmon analizën dhe orientimin e përmirësimit të politikave në lidhje me dhunën në familje;

ç) çdo anëtar i ekipit ndërdisiplinor, një herë në muaj, nëpërmjet formularit të mbledhjes së të dhënave, përcjell tek KV-ja informacionin për të gjitha rastet e paraqitura apo të trajtuara nga institucioni i tij/saj, pavarësisht nëse ndërhyrja ka qenë e përbashkët, ndërdisiplinore apo është trajtuar vetëm brenda institucionit;

d) KV-ja dokumenton të dhënat në lidhje me takimet e ETN-së dhe komitetin drejtues, pjesëmarrjen, diskutimet dhe ndjekjen e tyre. Këto të dhëna regjistrohen nga KV-ja dhe përpunohen e administrohen prej tij në një seksion të veçantë të sistemit elektronik REVALB;

dh) KV-ja, punonjësi i Policisë së Shtetit dhe të gjithë personat e institucionet që përfshihen në menaxhimin e rastit të dhunës kanë detyrimin të ruajnë fshehtësinë e të dhënave personale për viktimat e dhunës në familje, fëmijëve dhe anëtarëve të tjerë të familjes, si dhe të dhënave për dhunuesin;

e) drejtoria e shërbimeve sociale dhe KV-ja, me qëllim harmonizimin e të dhënave, bashkëpunojnë me organet e tjera që gjenerojnë të dhëna për rastet e dhunës në familje, sipas legjislacionit në fuqi, duke nënshkruar marrëveshje për bashkëpunimin ndërmjet tyre;

ë) KV-ja ndan një herë në muaj raportet e përditësuara që gjeneron sistemi REVALB, si dhe një informacion të përmbledhur për rastet e trajtuara me gjithë anëtarët e ekipit multidisiplinor. Sipas rastit, këto raporte mund të jenë të koduara, që sigurojnë fshehtësinë e emrit të viktimës;

f) KV-ja, bazuar në të dhënat e sistemit REVALB, paraqet raporte tremujore, gjashtëmujore dhe vjetore përpara komitetit drejtues dhe autoritetit kryesor përgjegjës. Në raport përfshihen në formë të përmbledhur të dhëna për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje, duke u kujdesur që të ruhet fshehtësia e të dhënave personale të viktimave. Këto raporte përmbajnë informacion për rastet në të cilat është ndërhyrë, për procedurat e ndjekura, masat e ndërmarra dhe problemet që janë ndeshur gjatë menaxhimit të rastit dhe mund të kërkojnë zgjidhje nga komiteti drejtues ose autoriteti kryesor përgjegjës.

14. Monitorimi i zbatimit të masave mbrojtëse ndaj dhunës realizohet, si më poshtë vijon:

a) gjatë kohëzgjatjes së vendimit gjyqësor për UM-në çdo 60 (gjashtëdhjetë) ditë, KV-ja dhe/ose punonjësi social i strukturës së shërbimeve shoqërore në bashki monitoron respektimin e masave të urdhrit të mbrojtjes nga pala përkatëse dhe harton raportin e monitorimit për zbatimin e masave mbrojtëse. Ky raport i bëhet i njohur menjëherë Policisë së Shtetit, së bashku me rekomandimet e KV-së;

b) kur nga monitorimi i zbatimit të masave të UMM-së/UM-së rezulton kryerja e veprimeve në kundërshtim me vendimin e gjykatës, në lidhje me masat e veçanta që urdhërohen prej saj, njoftohet menjëherë Policia e Shtetit, në çdo kohë, pa pritur të përmbushet afati 60-ditor;

c) nëse është rasti, KV-ja i kërkon të urdhëruarit të paraqitet dhe i bën me dije shkeljet e konstatuara, duke i tërhequr vëmendjen;

ç) raporti u paraqitet anëtarëve të ETN-së në mbledhjen më të parë, të cilët marrin masat e nevojshme sipas detyrave të lëna në raport;

d) raporti hartohet me shkrim, sipas një formati tip, siç është parashikuar në protokollin e menaxhimit të rasteve të dhunës në familje. Në çdo rast, raporti përmban:

i. veprimet e kryera në kundërshtim me vendimin e gjykatës për UM-në nga pala e urdhëruar, të cilat renditen të shkruara në një vend të dukshëm dhe i adresohen Policisë së Shtetit;

ii. mbarëvajtja e shërbimeve të ofruara nga subjektet që janë urdhëruar në vendimin e gjykatës;

iii. progresi i PPN-së;

iv. detyrat për të ardhmen.

15. ETN-ja, në bazë të raportit të paraqitur nga KV-ja, vlerëson mbarëvajtjen e rastit. Në vlerësimin e saj, ETN-ja mban parasysh:

a) nëse është ulur ose minimizuar niveli i riskut;

b) nëse janë kryer shërbimet e parashikuara në PPN;

c) nëse pas këtyre shërbimeve është kaluar trauma e dhunës së përjetuar nga viktima dhe janë kryer shërbimet për rehabilitimin e saj.

16. Kur nga vlerësimi i rastit rezulton se afati i urdhrit të mbrojtjes ka përfunduar dhe nuk kërkohet zgjatja e afatit të tij, si dhe kur rezultojnë të përmbushura detyrat e parashikuara në PPN, ETN-ja merr vendim për mbylljen e rastit.

17. Vendimi për mbylljen e rastit, kur rezulton se risku është i ulët, merret nga KV-ja, pasi ai ka hartuar raportin e vlerësimit. Ky vendim miratohet nga ETN-ja në mbledhjen më të parë të radhës.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij vendimi, ministri përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje miraton formatin bazë të protokollit të menaxhimit të rasteve të dhunës në familje dhe të dhunës ndaj grave përmes mekanizmit të koordinuar të referimit të rasteve të dhunës në familje dhe e boton atë në faqen zyrtare të internetit në një program që qaset lehtësisht nga publiku.

2. Vendimi nr. 334, datë 17.2.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", shfuqizohet.

3. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore dhe luftës kundër dhunës në familje, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, si dhe institucionet e tyre të varësisë, që lidhen me zbatimin e këtij vendimi, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 331, datë 2.6.2021

PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË STATUSIT NGA KATEGORIA E RESURSIT "TOKË BUJQËSORE" NË "TOKË URBANE", TRUALL, TË PASURISË ME NUMËR 1/68, ZONA KADASTRALE 3529, BASHKIA POGRADEC

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11/1, të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001, "Për krijimin dhe funksionimin e strukturave për administrimin dhe mbrojtjen e tokës", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimit të statusit, nga kategoria e resursit "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të sipërfaqes prej 4 700 m^2, pjesë e pasurisë me numër 1/68, zona kadastrale 3529, Bashkia Pogradec, sipas certifikatës të pasurisë, hartës treguese dhe lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës, qarku Korçë, të pasqyrojë në dokumentacionin kadastral (LN) ndryshimin e resursit nga "tokë bujqësore" në "tokë urbane", truall, të pasurisë me numër 1/68, zona kadastrale 3529, Bashkia Pogradec.

3. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të bëjë ndryshimin e llojit të pasurisë, në certifikatën e pasurisë, sipas të dhënave për pasurinë e përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Qarkut Korçë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 332, datë 2.6.2021

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2021, MIRATUAR PËR MINISTRINË E TURIZMIT DHE MJEDISIT, PËR PAGESËN E STUDIOS PËR ÇËSHTJEN E ANULIMIT TË VENDIMIT TË ARBITRAZHIT ICSID CASE NR. ARB/14/26

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin "Shpenzime korrente", të programit buxhetor 01110 "Planifikim, menaxhim, administrim", t'i shtohet fondi prej 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekësh, për kryerjen e pagesës për detyrimet që rrjedhin ndaj Studios "Gowling" WLG për procesin e anulimit të vendimit të arbitrazhit ndërkombëtar, datë 20.3.2020, ICSID Case No. ARB/14/26, ndërmjet shoqërisë "Albaniabeg Ambient" sh.p.k. dhe të tjerë, kundër Republikës së Shqipërisë.

2. Efekti financiar, prej 43 000 000 (dyzet e tre milionë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 64, datë 30.3.2021

PËR NGRITJEN DHE PËRBËRJEN E KOMITETIT SEKTORIAL TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE TË KOMUNIKIMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës; të pikës 1, të nenit 11, të ligjit nr. 10 247, datë 4.3.2010, "Për kornizën shqiptare të kualifikimeve", të ndryshuar; të vendimit nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për mënyrën e organizimit, të funksionimit, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të komiteteve sektoriale dhe mënyrën e shpërblimit të tyre", ministri përgjegjës për arsimin dhe formimin profesional dhe ministri përgjegjës për arsimin,

URDHËROJNË:

1. Ngritjen e Komitetit Sektorial të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

2. Komiteti Sektorial TIK, organizohet në formën e grupit teknik dhe ka në përbërje 10 (dhjetë) anëtarë si më poshtë:

a) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin;

b) një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional;

c) një përfaqësues nga ministria/institucioni përgjegjës për sektorin e TIK-ut;

ç) një përfaqësues nga shoqatat e punëdhënësve të sektorit të TIK-ut, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

d) një përfaqësues nga shoqatat e punëmarrësve që mbulojnë sektorin TIK, me numrin më të madh të anëtarëve në sektorin përkatës;

dh) një përfaqësues nga institucionet ofruese të arsimit dhe formimit profesional (AFP) të sektorit TIK, me numrin më të madh të nxënësve/kursantëve në sektorin përkatës;

e) një përfaqësues të biznesit me praktika të pasura në zhvillimin e burimeve njerëzore në sektorin TIK;

ë) tre ekspertë të pavarur, me përvojë jo më pak se 5 (pesë) vjet në zhvillimin dhe në zbatimin e Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK).

3. Kryetari zgjidhet në mbledhjen e parë të komitetit dhe, si rregull, duhet të jetë anëtari me më shumë eksperiencë në çështjet e TIK-ut dhe në zhvillimin e zbatimin e KSHK-së.

4. Ngarkohen ministritë përgjegjëse respektive për caktimin e anëtarëve të parashikuar në shkronjat "a", "b", "c" dhe "dh", të pikës 2, të këtij urdhri, në bazë të kritereve të parashikuara në vendimin nr. 426, datë 26.6.2019, të Këshillit të Ministrave, dhe përcjelljen e tyre Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve (AKAFPK), jo më vonë se 1 (një) muaj nga hyrja në fuqi e këtij urdhri.

5. Ngarkohet AKAFPK-ja për përzgjedhjen e anëtarëve të parashikuar në shkronjat "ç", "d", "e" dhe "ë", të pikës 2 të këtij urdhri, si dhe titullari i saj për ngritjen e sekretariatit teknik, brenda 1 (një) muaj nga hyrja e tij në fuqi.

6. Ngarkohen ministria përgjegjëse për arsimin dhe formimin profesional, ministria përgjegjëse për arsimin, Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve dhe Komiteti Sektorial i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Evis Kushi

VENDIM
Nr. 25, datë 10.5.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese		
Elsa Toska,	anëtare e	"	"
Fiona Papajorgji,	anëtare e	"	"
Altin Binaj,	anëtar i	"	"
Përparim Kalo,	anëtar i	"	"
Sonila Bejtja,	anëtare e	"	"
Marsida Xhaferllari,	anëtare e	"	"

me sekretare Enina Kotoni, në datat 6.4.2021 dhe 6.5.2021, mori në shqyrtim, në seancë plenare publike, çështjen nr. 1 (Z) 2019, të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Zef Hila, përfaqësuar nga avokati Jordan Daci, me prokurë.

SUBJEKT I INTERESUAR: Këshilli i Ministrave, përfaqësuar nga Elira Kokona dhe Abaz Deda, me autorizim.

OBJEKTI:Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 28.6.2019, "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Zef Hila", si i papajtueshëm me Kushtetutën.

BAZA LIGJORE:Nenet 3, 4, 5, 13, 17, 30, 33, 42, 115, pika 2; 116, 131, pika 1, shkronja "f"; 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës; nenet 6 dhe 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); neni 1, i Protokollit 12 të KEDNJ-së; Karta Evropiane e Autonomisë Vendore; ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore" *(ligji nr. 139/2015);* ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes, Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuesit, që kërkoi pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Këshillit të Ministrave, që kërkoi rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi është zgjedhur kryetar i Bashkisë së Vaut të Dejës në zgjedhjet e përgjithshme vendore të vitit 2015.

2. Presidenti i Republikës, me dekretin nr. 10928, datë 5.11.2018, ka caktuar mbajtjen e zgjedhjeve të përgjithshme vendore të radhës në datën 30.6.2019. Ky dekret është shfuqizuar nga Presidenti me dekretin nr. 11199, datë 10.6.2019, me të cilin është caktuar data 13.10.2019, për mbajtjen e zgjedhjeve.

3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (*KQZ*) ka vazhduar përgatitjet për mbajtjen e zgjedhjeve vendore në datën 30.6.2019.

4. Misioni vëzhgues i ODHIR-it, në raportin final të datës 5.9.2019, ka konstatuar se zgjedhjet vendore të vitit 2019, u mbajtën në një situatë krize politike dhe institucionale, që vinte nga një antagonizëm i hershëm mes partisë qeverisëse dhe partive opozitare. Këto të fundit ishin tërhequr nga Kuvendi në muajin shkurt të viti 2019 dhe vendosën të mos merrnin pjesë në zgjedhje. Duke shprehur shqetësime për sigurinë publike dhe përgjegjësinë e tij kushtetuese për të mbrojtur pluralizmin, më 10 qershor, Presidenti nxori një dekret përmes të cilit i anulonte zgjedhjet. Kuvendi e deklaroi të pavlefshëm këtë dekret dhe ndërmori një procedurë hetimore për shkarkimin e Presidentit nga detyra. Atmosfera e ngërçit dhe e pasigurisë juridike mes institucioneve kryesore minoi besimin e publikut te legjitimiteti i zgjedhjeve. Në muajin shkurt, në Tiranë, filluan protesta të vazhdueshme të opozitës kundër Kryeministrit, të cilat u shenjuan shpesh nga dhuna dhe vandalizmi i drejtuar kundër institucioneve shtetërore. Me afrimin e ditës së zgjedhjeve, protestuesit në pjesë të tjera të vendit vunë në shënjestër administratën zgjedhore, me përfshirjen shpesh të akteve të frikësimit, dhunës dhe zjarrvënies, si dhe përplasjeve me Policinë Bashkiake dhe Policinë e Shtetit *(shih Raportin Përfundimtar të Misionit të ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve vendore të 30 qershorit 2019, në Shqipëri, faqe 3).*

5. Në datën 27.6.2019, në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës është organizuar një tubim nga Aleanca Qytetare për Mbrojtjen e Demokracisë, për të shprehur pakënaqësinë për mosrespektimin e dekretit të Presidentit të Republikës që ka ndryshuar datën e zgjedhjeve vendore. Gjatë tubimit ka pasur përplasje midis Policisë së Shtetit dhe pjesëmarrësve në tubim, si dhe iu është vënë zjarri materialeve zgjedhore të KZAZ-së nr. 6 (të vendosur në ambientet e një shkolle), të Bashkisë së Vaut të Dejës.

6. Për këtë ngjarje është paraqitur kallëzimi penal nr. 1248, i vitit 2019, për kryerjen e veprave penale "Dëmtim me dashje i materialit zgjedhor", "Shkatërrimi i pronës me zjarr", "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik", të parashikuara nga nenet 326/a, 151 dhe 236 të Kodit Penal. Në datën 29.6.2019, kërkuesi është pyetur në Drejtorinë e Policisë Qarku Shkodër, në cilësinë e personit që kishte dijeni për veprat penale të lidhura me ngjarjen e datës 27.6.2019, në KZAZ-në nr. 6, të Bashkisë së Vaut të Dejës. Me vendimin nr. 1248, datë 15.7.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur "mosfillimin e procedimit penal" ndaj kërkuesit, me arsyetimin se mungonin elementet e veprës penale.

7. Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit të Brendshëm, ka marrë vendimin nr. 445, datë 28.6.2019, "*Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të bashkisë Vau i Dejës, z. Zef Hila*", me motivacionin "*për shkak të shkeljeve të rëndë*" (*vendimi nr. 445/2019*). Vendimi është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019.

8. Zgjedhjet vendore u zhvilluan në datën 30.6.2019, pa pjesëmarrjen e partive kryesore opozitare. Kërkuesi, si përfaqësues i një prej këtyre partive opozitare nuk kandidoi.

9. Në datën 5.7.2019, ai ka paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese *(Gjykata),* e cila prej datës 23 mars të vitit 2018, nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor, të parashikuar nga neni 32, pika 1, e ligjit nr. 8577/2000, për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Me plotësimin e kuorumit për funksionimin e kolegjeve dhe më pas edhe të Gjykatës, në datën 12.2.2020, u vendos nga Kolegji kalimi i çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 9.2.2021, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

10. Kërkuesi, Zef Hila, i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 445/2019, të Këshillit të Ministrave, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se janë cenuar:

10.1 E drejta për proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

10.1.1 Standardi i arsyetimit, pasi kërkuesi nuk ka kryer asnjë veprim ose mosveprim të paligjshëm, i cili mund të konsiderohet "shkelje e rëndë", faktet e paraqitura në vendim janë të natyrës penale, kërkuesi nuk është autor i tyre

dhe nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi kolektive për veprimet e kryera nga persona të tretë. Po ashtu, në vendimin e shkarkimit nuk është analizuar proporcionaliteti i shkeljeve në raport me masën e dhënë, gjë që bie në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, si dhe mungon arsyetimi i kritereve ligjore që përcakton ligji për masën e shkarkimit të kryetarit të bashkisë.

10.1.2 E drejta për t'u dëgjuar, pasi nuk është kërkuar asnjë sqarim nga kërkuesi në shkelje të nenit 10, të ligjit nr. 139/2015, nuk i është dhënë mundësia të dëgjohej e të paraqiste prova, si dhe nuk i është vënë në dispozicion asnjë akt. Këshilli i Ministrave ka vendosur me urgjencë në mbledhje të jashtëzakonshme për shkarkimin e tij, në shkelje të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave" (*ligji nr. 9000/2003*) dhe Rregulloren e Këshillit të Ministrave (*Rregullorja*).

10.1.3 Prezumimi i pafajësisë, pasi ministri i Brendshëm, përpara mbledhjes, në deklaratën për shtyp, përtej kompetencave të tij, ka njoftuar shkarkimin e kërkuesit, duke e paragjykuar fajësinë e tij. Po kështu, edhe Kryeministri, në të njëjtën datë, ka deklaruar shkarkimin e tij në rrjetet sociale, të shoqëruar nga fotoja e vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij.

10.2 E drejta për të mos u diskriminuar për bindjet politike, e parashikuar në nenin 14 të KEDNJ-së, pasi Këshilli i Ministrave ka marrë vendim shkarkimi vetëm ndaj kërkuesit, ndërkohë që ngjarje të tilla me pasoja edhe më të rënda kanë ndodhur edhe në bashki të tjera të vendit.

10.3 Parimi i decentralizimit dhe *ai i autonomisë së pushtetit vendor*, si dhe garancitë kushtetuese për funksionimin dhe organizimin e pushtetit vendor, të njohura nga neni 13 i Kushtetutës dhe Karta Evropiane e Autonomisë Vendore, pasi vendimi i Këshillit të Ministrave ka cenuar të drejtën dhe aftësinë efektive të Bashkisë së Vaut të Dejës dhe të kryetarit të saj për të rregulluar dhe drejtuar çështjet publike nën përgjegjësinë e tij.

10.4 Dinjiteti njerëzor, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, drejtësia shoqërore dhe rendi kushtetues, të mbrojtura nga neni 3 i Kushtetutës, pasi kërkuesi është ngarkuar me faj në mënyrë hipotetike për veprime ose mosveprime të kryera nga persona të tjerë.

10.5 Parimet e ligjshmërisë, shtetit të së drejtës dhe *hierarkisë së normave*, të sanksionuara në nenet 4 dhe 116, të Kushtetutës, pasi mbledhja e jashtëzakonshme e Këshillit të Ministrave që ka vendosur për shkarkimin e kërkuesit është mbajtur në kundërshtim me Rregulloren dhe ligjin nr. 9000/2003, për sa i përket vlerësimit të urgjencës dhe zbatimit të kritereve procedurale.

10.6 E drejta e tubimit dhe organizimit, si dhe *liria e shprehjes*, të garantuara nga nenet 47 dhe 22, të Kushtetutës, pasi tubimi është organizuar nga persona të tjerë, të cilët kanë shprehur pakënaqësinë e tyre ndaj mosrespektimit të dekretit të Presidentit për ndryshimin e datës së mbajtjes së zgjedhjeve vendore.

11. Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave, ka prapësuar se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, duke parashtruar në mënyrë të përmbledhur argumentet si vijon:

11.1 Vendimi nr. 445/2019, është i arsyetuar, pasi relacioni shpjegues i tij jep arsyet e shkarkimit dhe tregon se Këshilli i Ministrave ka respektuar nenet 100 dhe 115, të Kushtetutës, si dhe nenin 62/a, të ligjit nr. 139/2015. Kërkuesi ka kryer shkelje të rënda lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve në datën e caktuar, duke krijuar një situatë kaosi dhe pasigurie në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës, me episode të përsëritura dhe pasoja të rënda për interesin publik. Vendimi i shkarkimit është proporcional për të parandaluar situatën kaotike dhe për të siguruar mbarëvajtjen e procesit zgjedhor.

11.2 Vendimmarrja e Këshillit të Ministrave nuk ka cenuar të drejtën për t'u dëgjuar të kërkuesit për shkak të urgjencës së situatës së krijuar në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës dhe cenimit të interesit publik. Vlerësimi i urgjencës është në diskrecion të Këshillit të Ministrave. Neni 89, i Kodit të Procedurave Administrative *(KPA),* parashikon se në rastet e urgjencës përjashtohet mundësia e palëve për t'u dëgjuar. Megjithatë, vendimi i shkarkimit është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019, si dhe i është dërguar Bashkisë së Vaut të Dejës nga ministri i Brendshëm, me shkresën nr. 3346/2, datë 19.7.2019. Relacioni shpjegues nuk i është dhënë kërkuesit, pasi ai nuk ka paraqitur asnjë kërkesë të tillë.

11.3 Parimet e decentralizimit dhe të autonomisë vendore nuk janë cenuar, pasi njësitë e qeverisjes vendore, gjatë veprimtarisë së tyre, duhet të respektojnë Kushtetutën, ligjet dhe aktet

e tjera të nxjerra në zbatim të tyre. Kërkuesi ka kryer shkelje të rënda, që dëmtojnë imazhin e zyrtarit publik dhe janë të lidhura ngushtë me ushtrimin e rregullt të funksionit të tij, duke përmbushur kushtet për shkarkimin e tij nga Këshilli i Ministrave sipas ligjit nr. 139/2015.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimimin e kërkuesit

12. Neni 115 i Kushtetutës, në pikat 1 dhe 2, të tij parashikon se organi i zgjedhur drejtpërdrejt i njësisë qeverisëse vendore, mund të shkarkohet nga Këshilli i Ministrave për shkelje të rënda të Kushtetutës ose të ligjeve dhe se ai mund të ankohet për këtë shkarkim në Gjykatën Kushtetuese brenda 15 ditëve.

13. Gjykata është shprehur në jurisprudencën e saj se një gjykim, i cili ka për objekt shkarkimin nga detyra të organeve të qeverisjes vendore, është gjykim në themel i kërkesës. Gjykata Kushtetuese, si organ kontrolli, për të çmuar shkeljen e rëndë të Kushtetutës ose ligjit heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm *(shih vendimet nr. 15, datë 8.6.2009; nr. 22, datë 7.10.2008; nr. 39, datë 29.12.2005, të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Gjykata konstaton se kërkuesi nuk ka kandiduar për t'u zgjedhur në zgjedhjet e përgjithshme vendore të zhvilluara më 30 qershor 2019 dhe pas zhvillimit të tyre, detyrën e kryetarit të Bashkisë së Vau të Dejës e ka marrë një shtetas tjetër. Në kohën kur Këshilli i Ministrave ka vendosur shkarkimin nga detyra të kërkuesit, mandati i tij si organ i zgjedhur i qeverisjes vendore ishte drejt përfundimit. Megjithatë, pavarësisht këtyre rrethanave të pranuara edhe nga kërkuesi, ai gjatë seancës plenare ka parashtruar se ka interes në shqyrtimin e ankimit të tij në drejtim të rivendosjes së integritetit, që sipas tij i është cenuar si pasojë e shkarkimit nga detyra në mungesë të kryerjes së shkeljes së rëndë. Legjislacioni, prej vitit 2015 e në vijim, ka pësuar ndryshime në drejtim të standardeve të larta të integritetit dhe shkeljet disiplinore konsiderohen si kriter ndalues për zgjedhjen ose emërimin në pozicione të ndryshme publike, prandaj, ai ka interes të ligjshëm t'i drejtohet Gjykatës për të rivendosur integritetin e tij në këtë drejtim dhe për të eliminuar pengesat eventuale në të ardhmen për të mbajtur pozicione publike.

15. Gjykata, në kontekstin e argumenteve të parashtruara nga kërkuesi për interesin e ligjshëm, sjell në vëmendje edhe raportet që ekzistojnë midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore, duke pohuar se shkarkimi nga detyra ose shpërndarja e organeve të qeverisjes vendore është një masë ndërhyrjeje që ushtrohet mbi këto organe nga qeverisja qendrore, për rrjedhojë procedura dhe kriteret e përcaktuara nga neni 115 i Kushtetutës duhet të zbatohen në funksion të autonomisë vendore.

16. Për sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë faktin që subjekti i interesuar nuk ka paraqitur asnjë prapësim mbi interesin e ligjshëm të kërkuesit, Gjykata çmon se kërkuesi legjitimohet në këtë gjykim kushtetues, pasi justifikon interesin e ligjshëm, e ka paraqitur kërkesën brenda afatit 15 - ditor të parashikuar nga neni 115 i Kushtetutës, si dhe në themel ngre pretendime që lidhen me procedurën dhe kriteret e shkarkimit të tij nga detyra.

B. Për themelin e pretendimeve

17. Gjykata ka pohuar se gjatë ushtrimit të kontrollit kushtetues të aktit të shkarkimit të organit të qeverisjes vendore, sipas nenit 115 të Kushtetutës, ajo, fillimisht, duhet të vlerësojë nëse organi procedues, Këshilli i Ministrave, i ka respektuar kërkesat kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, dhe, më pas, çmon bazueshmërinë/meritën e aktit të shkarkimit (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese).*

18. Kërkuesi, krahas pretendimeve kryesore për mosrespektimin e procesit të rregullt ligjor dhe të kritereve të shkarkimit nga detyra, ka pretenduar edhe cenimin e dinjitetit të njeriut, të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, drejtësisë shoqërore, rendit kushtetues, parimeve të ligjshmërisë, shtetit të së drejtës dhe hierarkisë së normave, të drejtës së tubimit dhe organizimit, si dhe lirisë së shprehjes. Gjykata, duke iu referuar mënyrës se si janë paraqitur këto pretendime, vlerëson se ato shërbejnë si argumente të lidhura ngushtë dhe në funksion të pretendimeve të kërkuesit për procesin e rregullt ligjor dhe për masën e shkarkimit nga detyra, sipas nenit 115 të

Kushtetutës. Për rrjedhojë, ndonëse në themel të ankimit kërkuesi ka paraqitur një listë pretendimesh, Gjykata do t'i analizojë ato të grupuara në dy drejtime: i. për procesin e rregullt ligjor; dhe ii. për masën e shkarkimit nga detyra.

B.1 Për të drejtën për një proces të rregullt ligjor

19. Kërkuesi pretendon se vendimi i shkarkimit të tij nga detyra është rezultat i një procesi të parregullt ligjor, pasi janë cenuar e drejta për t'u dëgjuar, standardi i arsyetimit të vendimit të Këshillit të Ministrave dhe e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm.

20. Subjekti i interesuar, duke iu referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, prapëson se për të zgjedhurit vendorë politikë nuk zbatohen garancitë e procesit të rregullt ligjor, të parashikuara nga neni 6 i KEDNJ-së.

21. Gjykata ka pohuar se kur vihet në lëvizje nga organi i zgjedhur vendor, që ankohet ndaj vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin e tij nga detyra, ajo kontrollon nëse gjatë procesit disiplinor administrativ është garantuar përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij, e drejta për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 37, datë 25.7.2013; nr. 32, datë 10.7.2013; nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese).* Gjykata është organi i vetëm që shqyrton ankesën e organit të qeverisjes vendore kundër vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin ose shpërndarjen e tij. Ajo e bën këtë shqyrtim si nga pikëpamja e faktit, ashtu dhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural. Gjykimi i çështjeve të tilla ka për objekt një akt administrativ me karakter individual, kushtetutshmërinë dhe ligjshmërinë e të cilit e shqyrton drejtpërdrejt Gjykata Kushtetuese. Në çështje të ngjashme, Gjykata e ka vlerësuar aktin e shkarkimit të organit të zgjedhur të njësisë vendore në këndvështrim të procesit të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 32, datë 10.7.2013; nr. 37, datë 25.7.2013; nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese).*

22. Për sa më lart, në kushtet kur neni 115 i Kushtetutës parashikon në mënyrë të shprehur të drejtën e ankimit në Gjykatën Kushtetuese për procedurën e shkarkimit, që sipas jurisprudencës konstante kushtetuese duhet të përmbushë standardet e procesit të rregullt ligjor, Gjykata çmon se pretendimi i Këshillit të Ministrave se të zgjedhurit vendorë politikë nuk përfitojnë nga garancitë e procesit të rregullt ligjor gjatë procedurës së shkarkimit nga detyra, nuk qëndron.

23. Në vijim, Gjykata do të analizojë aspektet e procesit ligjor të zhvilluar ndaj kërkuesit, sipas pretendimeve të ngritura prej tij.

B.1.1 Për të drejtën për t'u njoftuar dhe për t'u dëgjuar

24. Kërkuesi ka parashtruar se i është cenuar e drejta për t'u dëgjuar, për arsye se Këshilli i Ministrave nuk ka bërë asnjë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen dhe nuk i ka kërkuar informacion ose sqarim kërkuesit lidhur me shkeljet e pretenduara. Atij nuk i është dhënë mundësia të dëgjohej dhe të paraqiste prova, si dhe nuk i janë vënë në dispozicion aktet e domosdoshme të procesit të shkarkimit që është zhvilluar nga Këshilli i Ministrave (akti i propozimit, relacioni i ministrit, njoftimi i mbajtjes së mbledhjes, praktika për miratimin e rendit të ditës, procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, regjistrimi audio i mbledhjes kur është marrë vendimi i shkarkimit). Sipas kërkuesit, procesi i shkarkimit është bërë me urgjencë dhe nuk janë respektuar rregullat procedurale të ligjit nr. 9000/2003 dhe të Rregullores.

25. Subjekti i interesuar ka parashtruar se vendimmarrja e tij ka qenë urgjente për shkak të situatës së krijuar në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës dhe cenimit të interesit publik. Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e vendimit nr. 445/2019 i është nënshtruar të gjitha rregullave të parashikuara nga ligji dhe Rregullorja për zhvillimin e një mbledhjeje të jashtëzakonshme, duke pasur parasysh edhe rastet ku sipas ligjit përjashtohet mundësia e palëve për t'u shprehur. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, vendimi i shkarkimit është publikuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019, dhe në datën 19.7.2019, i është dërguar Bashkisë së Vaut të Dejës nga ministri i Brendshëm. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për të kërkuar relacionin shoqërues të vendimit të shkarkimit.

26. Gjykata, gjatë shqyrtimit të ankimeve të organeve të qeverisjes vendore ndaj shkarkimit nga detyra, ka theksuar se e drejta e individit për

një proces të rregullt ligjor, e parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, nuk është e kufizuar vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ. Çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake, ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore (*shih vendimet nr. 29, datë 27.6.2013; nr. 37, datë 25.7.2013, të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka pohuar, gjithashtu, se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij, ose avokatit të zgjedhur *(shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese).*

27. Në kushtet kur Gjykata, gjatë shqyrtimit të ankimit sipas nenit 115 të Kushtetutës, verifikon edhe ligjshmërinë e procesit, ajo është shprehur se KPA-ja parashikon se çdokush që ka interes të ligjshëm ka të drejtë të marrë pjesë në procedimin administrativ. Palët pjesëmarrëse në një procedim administrativ janë autoriteti kompetent, nga njëra anë dhe pala e interesuar, nga ana tjetër. Megjithatë, procedimi administrativ nuk zhvillohet përherë në prani të palëve të interesuara dhe jo çdo herë kjo e fundit mund të shprehet lidhur me procedimin. KPA-ja parashikon rastet kur përjashtohet mundësia e palëve për t'u shprehur, mes të cilave edhe kur palët e interesuara kanë pasur rast t'i japin mendimet e tyre për çështjet që kanë rëndësi për marrjen e vendimit *(shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese).*

28. Gjykata vëren se jurisprudenca e mësipërme është zhvilluar duke analizuar nenet 44, 93 dhe 96, të KPA-së, të miratuara me ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999, i cili tashmë është shfuqizuar me ligjin nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative". Megjithatë, jurisprudenca e mësipërme është e zbatueshme edhe pas këtij ndryshimi ligjor, pasi kodi aktual bazohet në të njëjtat parime themelore të procedimit administrativ dhe përmban rregulla me përmbajtje të ngjashme, për sa i takon pjesëmarrjes në procedim dhe së drejtës së palës për t'u dëgjuar (*shih nenet 33, 42, 45, 47, 88 dhe 89, të KPA-së*).

29. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata vëren se relacioni i ministrit të Brendshëm dhe vendimi nr. 445/2019 i Këshillit të Ministrave për shkarkimin e kërkuesit nga detyra mbajnë të njëjtën datë, konkretisht datën 28.6.2019 dhe i referohen ngjarjes së ndodhur në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës në datën 27.6.2019. Vendimi i shkarkimit është botuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019, ndërsa kërkuesit i është komunikuar me shkrim në datën 19.7.2019.

30. Faktet e mësipërme tregojnë se procedura e shkarkimit është realizuar brenda 24 orëve, pra nga pikëpamja kohore është karakterizuar nga urgjenca, në vijim publikimi i aktit të shkarkimit është zhvilluar me procedurë normale, ndërsa kërkuesi është njoftuar individualisht pas 21 ditësh. Duke qenë se procedura e shkarkimit është zhvilluar në mënyrë urgjente, kërkuesi nuk rezulton të jetë njohur paraprakisht me shkeljet të cilat i janë atribuuar, në mënyrë që, në një ballafaqim procedural, të mund të paraqiste kundërshtimet e tij ndaj këtyre shkeljeve. Pra, atij nuk i është dhënë mundësia të realizojë të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur shpjegime, në kuadrin e procesit të rregullt ligjor. Pyetjes së Gjykatës në këtë drejtim, subjekti i interesuar iu përgjigj në seancë plenare se nuk kishte pasur asnjë komunikim me kërkuesin, qoftë edhe me mjete teknologjike, që mund të garantonin shpejtësinë e njoftimit.

31. Në këtë situatë, Gjykata do të analizojë nëse në rastin konkret ka pasur vend për të zbatuar një prej përjashtimeve nga e drejta për t'u dëgjuar sipas nenit 89 të KPA-së, që parashikon se procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës për t'u dëgjuar, kur marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i vijë interesit publik nga vonesa.

32. Subjekti i interesuar ka parashtruar se vendimi i shkarkimit është marrë në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave dhe në kushtet e urgjencës për shkak të situatës së krijuar në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës. Sipas tij, është zbatuar përjashtimi ligjor nga e drejta për t'u dëgjuar, i parashikuar nga neni 89 i KPA-së, pasi në rastin konkret është cenuar interesi publik nga dhuna e shkaktuar ndaj policëve, djegia e materialeve zgjedhore dhe mosmarrja e asnjë mase administrative nga kërkuesi ndaj punonjësve të Bashkisë së Vaut të Dejës, të cilët në mënyrë të përsëritur kanë bllokuar disa akse rrugore. Për të mbështetur këtë pretendim, Këshilli i Ministrave ka parashtruar fillimisht se dispononte informacion të klasifikuar sekret shtetëror që tregonte cenimin e interesit publik. Pasi iu dha koha e nevojshme nga Gjykata për të deklasifikuar informacionin, ai e paraqiti në gjykim dhe nga përmbajtja rezultoi se bëhej fjalë për një raport të hartuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, me të njëjtën përmbajtje faktike që ishte pasqyruar në relacionin shoqërues të vendimit të Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të kërkuesit, i cili nuk ishte klasifikuar asnjëherë si sekret shtetëror.

33. Kërkuesi ka prapësuar pretendimin për kushtet e urgjencës, duke parashtruar disa argumente. Kështu, sipas tij, ndjekja e procedurës urgjente administrative nuk mund të përdoret, sepse nuk ka asnjë efekt, pasi shkarkimi nga detyra i kryetarit të bashkisë pezullohet me paraqitjen e ankimit në Gjykatën Kushtetuese. Nga ana tjetër, sipas kërkuesit, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë vendimin nr. 445/2019, për shkarkimin nga detyra të kërkuesit në shkelje të procedurave të përcaktuara nga ligji nr. 9000/2003, pasi mbledhja nuk është zhvilluar fare.

34. Gjykata vëren se neni 14, i ligjit nr. 9000/2003, lejon mbledhjet e jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave, në raste të veçanta, kur thirret nga Kryeministri ose, në mungesë dhe me porosi të tij, edhe nga zëvendëskryeministri. Ndonëse iu kërkua nga Gjykata, subjekti i interesuar nuk ka paraqitur të dhëna dhe as dokumente për të dëshmuar thirrjen e kësaj mbledhjeje, rendin e ditës, vendin e zhvillimit të saj ose pjesëmarrësit në të, duke pretenduar se aktet që përmbajnë këto të dhëna ekzistojnë, por nuk mund të paraqiten për shqyrtim në Gjykatë, pasi janë të mbrojtura nga konfidencialiteti.

35. Nga ana tjetër, Gjykata konstaton se aktet e paraqitura nga subjekti i interesuar, duke përfshirë edhe shpjegimet në seancë, nuk argumentojnë mjaftueshëm dëmin urgjent që i vinte interesit publik nëse ndaj kërkuesit do të ishte ndjekur një procedurë normale disiplinore, me të cilën t'i jepej koha e duhur për t'u njohur me aktet dhe për të paraqitur shpjegimet e tij. Duke iu referuar situatës faktike, mbi të cilën Këshilli i Ministrave ka bazuar shkarkimin nga detyra të kërkuesit, vihet re se atij i janë atribuuar dy grupe faktesh disiplinore. Grupi i parë përmbledh veprimet e kryera nga kërkuesi në cilësinë e kryetarit të bashkisë, konkretisht urdhri për ndërprerjen e veprimtarisë zgjedhore i datës 17.6.2019 dhe aktet e tjera të nxjerra në datën 18.6.2019, për zbatimin e këtij urdhri, të cilat megjithëse janë veprime të lidhura me funksionin e tij si organ i qeverisjes vendore, nuk e justifikojnë urgjencën dhe përjashtimin nga e drejta për t'u dëgjuar, sipas nenit 89 të KPA-së. Grupi i dytë i fakteve përmbledh veprimet me natyrë penale, të cilat janë kryer në datën 27.6.2019, (konkretisht, dëmtimi me dashje, me anë të zjarrvënies i materialeve zgjedhore dhe kundërshtimi i policisë), për të cilat kompetenca e ndërhyrjes urgjente i takon Policisë së Shtetit dhe prokurorisë.

36. Duke qenë se qëllimi i Këshillit të Ministrave në këtë procedurë urgjente ka qenë ndërprerja ose parandalimi i veprave penale zgjedhore, duhet vënë në dukje se funksioni i ndërprerjes së veprave penale dhe i parandalimit të tyre i përket sferës juridiksionale të kompetencave publike që ushtrohen nga gjykata, prokuroria dhe Policia e Shtetit, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale, të cilat, gjithashtu, respektojnë standardet e procesit të rregullt ligjor, duke përfshirë të drejtën për t'u njoftuar, për t'u dëgjuar dhe për të dhënë shpjegime. Në këtë situatë, Gjykata çmon se procedura urgjente e shkarkimit nga detyra nuk sillte ndikim jo vetëm në drejtim të administrimit të Bashkisë së Vaut të Dejës, por as në drejtim të ndërprerjes dhe parandalimit të veprave penale në territorin e kësaj bashkie, për të cilat vepron një mekanizëm i ndryshëm institucional, sipas rregullave ligjore të tjera.

37. Për arsyet e mësipërme, Gjykata vlerëson se në procesin e shkarkimit të kërkuesit nuk janë respektuar në nivelin minimal e drejta për t'u njoftuar dhe e drejta për t'u dëgjuar, edhe pse

nuk rezulton të ketë pasur shkak ligjor për të mos respektuar këto të drejta.

B.1.2 Për standardin e arsyetimit të vendimit të Këshillit të Ministrave

38. Kërkuesi ka pretenduar se vendimi nr. 445/2019, nuk ka respektuar standardin e arsyetimit, pasi ai nuk ka kryer asnjë veprim ose mosveprim të paligjshëm, i cili mund të konsiderohet si "shkelje e rëndë", sipas ligjit nr. 139/2015. Përkundrazi, me vendimin nr. 1248, datë 15.7.2019, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër ka vendosur "mosfillimin e procedimit penal" ndaj kërkuesit, me arsyetimin se mungojnë elementet e veprës penale. Në vendimin e shkarkimit nuk është analizuar proporcionaliteti i shkeljeve në raport me masën e dhënë ndaj kërkuesit, në kundërshtim me nenin 17 të Kushtetutës, si dhe mungon arsyetimi i kritereve ligjore që përcakton ligji për masën e shkarkimit të kryetarit të bashkisë.

39. Subjekti i interesuar ka prapësuar se vendimi nr. 445/2019, është i arsyetuar dhe i shoqëruar nga relacioni shpjegues lidhur me arsyet e shkarkimit të kërkuesit. Ky i fundit, me vendimmarrjet e tij konkrete, të detajuara në relacionin shpjegues, ka kryer shkelje të rënda, duke mos respektuar vendimin nr. 12/2019, të Kolegjit Zgjedhor për mbajtjen e zgjedhjeve në datën e caktuar dhe duke krijuar një situatë kaosi dhe pasigurie në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës, me episode të përsëritura dhe pasoja të rënda për interesin publik. Ai ka lejuar punonjësit e administratës së bashkisë të marrin pjesë në grumbullime të paligjshme gjatë orarit të punës dhe të bllokojnë rrugë nacionale, pa marrë asnjë masë ndaj tyre. Gjithashtu, sipas subjektit të interesuar, kërkuesi, pavarësisht se nuk ishte vetë prezent, ka organizuar një grup personash, mes të cilëve edhe familjarë të tij, të cilët kanë hyrë me dhunë në KZAZ-në nr. 6 dhe u kanë vënë zjarrin materialeve zgjedhore.

40. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në rastin e procedurave të shkarkimit të organeve të zgjedhura vendore, edhe pse relacioni i ministrit të Brendshëm që shoqëron projektvendimin për shkarkim dhe vendimi i Këshillit të Ministrave që miraton shkarkimin e organit të zgjedhur të njësisë së qeverisjes vendore u përkasin dy organeve të ndryshme, ato janë të lidhura me njëra-tjetrën dhe përfaqësojnë një proces të pandashëm (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese*).

41. Gjykata, gjithashtu, ka vënë në dukje se sipas KPA-së arsyetimi i aktit administrativ duhet të jetë i qartë dhe të përfshijë shpjegimin e bazës ligjore dhe faktike të aktit. Kur arsyetimi është bërë bazuar në informacionet apo propozimet e mëparshme, mund të mjaftojë si arsyetim pranimi i tyre nga ana e organit përgjegjës për marrjen e vendimit përfundimtar dhe, në këto raste, informacionet dhe propozimet e mëparshme janë pjesë përbërëse e aktit (*shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese)*. Kjo jurisprudencë e zhvilluar, duke analizuar nenin 109 të Kodit të Procedurave Administrative, tashmë të shfuqizuar, është e zbatueshme edhe për Kodin e ri të Procedurave Administrative, pasi ky i fundit bazohet në të njëjtat parime themelore të procedimit administrativ dhe përmban rregulla për elementet e detyrueshme të arsyetimit të aktit administrativ, madje duke i zhvilluar edhe më tej detyrimet e organit publik në këtë drejtim (*shih nenet 99–101*). Sipas KPA-së në fuqi, përveç elementeve formale, akti administrativ duhet të jetë i qartë dhe të përmbajë, krahas shpjegimit të situatës faktike mbi të cilën është marrë akti, edhe shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave, bazën ligjore të aktit, një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast, si dhe në rastin e diskrecionit, shpjegimin pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e përcaktuar.

42. Duke iu kthyer çështjes konkrete, Gjykata konstaton se vendimi i kundërshtuar është bazuar në propozimin e ministrit të Brendshëm, i cili ka hartuar dhe nënshkruar relacionin shpjegues. Ky relacion është bazuar në informacionin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Këto dy akte kanë përmbajtje të ngjashme dhe përshkruajnë situatën faktike, mbi bazën e së cilës është marrë vendimi i kundërshtuar, duke shpjeguar veprimtarinë e kërkuesit, të familjarëve të tij dhe të punonjësve të Bashkisë së Vaut të Dejës. Konkretisht, me anë të shkresës nr. 3406, datë 24.6.2019, drejtuar KQZ-së, Komisariatit të Policisë së Vaut të Dejës dhe Misionit të OSBE/ODIHR, kërkuesi

ka kërkuar vendosjen në dispozicion të qytetarëve të ambienteve të KZAZ-së nr. 6 në Bashkinë e Vaut të Dejës në datat 27.6.2019 – 2.7.2019 për organizimin e aktiviteteve të ndryshme artistike, kulturore dhe letrare ose tubimeve, pasi, sipas tij, ka një dekret të Presidentit të Republikës që anulon datën e zgjedhjeve vendore. Më tej, në relacion shpjegohet se nga kryerja e veprimeve hetimore, në datën 27.6.2019, kërkuesi, megjithëse nuk ishte vetë prezent, ka organizuar një grup prej 150–200 personash, duke përfshirë punonjës të Bashkisë së Vaut të Dejës dhe familjarë të tij, të cilët kanë sulmuar punonjësit e policisë dhe u kanë vënë zjarrin materialeve zgjedhore që ndodheshin në KZAZ-në nr. 6. Sipas relacionit, në bazë të informacionit të Policisë së Shtetit, kërkuesi, edhe pse nuk ka marrë pjesë vetë në veprime aktive, në datat 26.4.2019, 2.5.2019 dhe 20.6.2019, ka organizuar/angazhuar punonjësit e Bashkisë së Vaut të Dejës për të bllokuar disa akse rrugore dhe për të penguar zhvillimin e aktiviteteve elektorale. Për këto arsye, ministri i Brendshëm, në relacionin e tij, ka propozuar shkarkimin e kërkuesit nga detyra, bazuar në nenin 62, shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015.

43. Nga ana tjetër, Gjykata vëren se në relacionin shpjegues të vendimit të kundërshtuar, përveçse paraqiten si referenca neni 62, shkronja "a", e ligjit nr. 139/2015, si dhe nenet 100 dhe 115, të Kushtetutës, nuk evidentohen elementet e tjera të arsyetimit, që kërkohen nga neni 100 i KPA-së, në mënyrë të veçantë nuk jepet shpjegim i mjaftueshëm pse veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe, ajo që është më e rëndësishmja, mungon shpjegimi pse Këshilli i Ministrave ka përdorur diskrecionin për t'u mbledhur dhe vendosur në kushtet e urgjencës.

44. Procesi i shkarkimit fillon me fazën e vlerësimit të shkeljeve nga ministri i Brendshëm dhe përfundon me vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave që miraton vlerësimin e bërë nga ministri i Brendshëm. Janë pikërisht këto dy organe të cilat realizojnë, sipas kompetencave përkatëse të tyre, në mënyrë të pashkëputur, procesin administrativ të shkarkimit nga detyra të organeve vendore. Për arsye të rolit të rëndësishëm që ato kanë, duhet të respektojnë me rigorozitet standardet e procesit të rregullt ligjor. Në këtë kontekst, relacioni i ministrit të Brendshëm duhet të hartohet duke mbajtur në konsideratë kërkesat e arsyetimit të aktit administrativ të përcaktuara nga KPA-ja, sidomos vlerësimin se përse faktet përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve nga organi i zgjedhor vendor. Këto elemente nuk janë të pasqyruara në mënyrë të mjaftueshme në relacionin e ministrit të Brendshëm, mbi të cilin është bazuar edhe vendimi nr. 445/2019, i Këshillit të Ministrave, për shkarkimin e kërkuesit. Ndërsa, lidhur me urgjencën e rastit, vlerësimi i së cilës siç shpjegoi subjekti i interesuar, është në përgjegjësinë dhe diskrecionin e tij, relacioni nuk përmban asnjë të dhënë, duke mos respektuar detyrimin e përcaktuar shprehimisht nga neni 100, pika 1, shkronja "ç", i KPA-së. Kjo e metë e arsyetimit të aktit është me rëndësi të veçantë, pasi zhvillimi i procedurës urgjente është përdorur nga subjekti i interesuar edhe për t'u shmangur nga detyrimi për të njoftuar dhe dëgjuar kërkuesin, siç u arsyetua më lart në këtë vendim.

45. Për rrjedhojë, nisur nga analiza e mësipërme, Gjykata vlerëson se vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të kërkuesit nuk respekton standardin e arsyetimit.

B.1.3 Për prezumimin e pafajësisë

46. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se i është cenuar e drejta për t'u prezumuar i pafajshëm, pasi ministri i Brendshëm, në deklaratën për shtyp të datës 28.6.2019, ka deklaruar shkarkimin e kërkuesit. Sipas tij, ky parim zbatohet përtej procesit penal, duke përfshirë edhe procedurat administrative disiplinore.

47. Parimi i prezumimit të pafajësisë garantohet nga neni 30 i Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë.

48. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se në rastet e shkarkimit të funksionarëve të lartë kushtetues parimet e prezumimit të pafajësisë dhe të paanësisë nuk mund të zbatohen si parime tipike klasike të proceseve gjyqësore, kur organet e ngarkuara me këto procedura, qoftë në përbërjen dhe organizimin e tyre, qoftë në veprimtarinë e

funksionet e tyre, nuk mund të jenë organe gjyqësore, nuk ushtrojnë pushtet gjyqësor, por ushtrojnë pushtete të tjera të ndryshme (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008, të Gjykatës Kushtetuese*).

49. Duke iu referuar jurisprudencës së mësipërme, Gjykata çmon se Këshilli i Ministrave, kur shkarkon nga detyra organin e zgjedhur të qeverisjes vendore, zhvillon një proces administrativo-disiplinor, i cili ka parimet e veta që lidhen me verifikimin, analizën dhe vërtetimin e shkaqeve konkrete që i kanë shërbyer organit kompetent për të marrë masën e shkarkimit. Ky proces duhet të respektojë standardet e procesit të rregullt ligjor të përcaktuara nga Kushtetuta dhe ligji (*shih paragrafët 21–22, të këtij vendimi*). Megjithatë, parimi i prezumimit të pafajësisë nuk gjen zbatim si në procesin gjyqësor penal, jo vetëm për shkak të natyrës administrativo-disiplinore të këtij procesi, por edhe për shkak të përbërjes dhe funksioneve politike të Këshillit të Ministrave.

50. Nisur nga sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

B.2 Për masën e shkarkimit nga detyra

51. Kërkuesi pretendon se është shkarkuar nga detyra e kryetarit të bashkisë në mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 115, pika 1, i Kushtetutës, pasi ai nuk ka kryer asnjë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, siç e kërkon kuadri ligjor për shkarkimin e tij. Përkundrazi, ai argumenton se është shmangur publikisht nga aktet e dhunës dhe u ka bërë thirrje qytetarëve për qetësi dhe vetëpërmbajtje, duke kërkuar të mos dëmtohej prona dhe interesat e qytetarëve. Kërkuesi pretendon se motivacioni i shkarkimit të tij bazohet në veprime ose mosveprime të karakterit penal, çka nuk përbën shkak për shkarkim nga Këshilli i Ministrave, pa pasur më parë një vendim penal të formës së prerë me të cilin kërkuesi të ishte shpallur fajtor për kryerjen e një vepre penale. Ai pretendon se nuk ka qenë fare në vendngjarje kur është djegur shkolla dhe materialet zgjedhore. Sipas tij, shkarkimi nga detyra ka motivacion politik dhe është arbitrar. Kërkuesi pretendon se është diskriminuar për arsye politike, pasi Këshilli i Ministrave nuk ka kryer hetimin e duhur përpara se të merrte vendimin e shkarkimit.

52. Subjekti i interesuar prapëson duke argumentuar se kërkuesi ka kryer shkelje të rënda kushtetuese, pasi ka vepruar për pengimin e procesit zgjedhor vendor të caktuar në datën 30.6.2019, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 109 të Kushtetutës për periodicitetin e zgjedhjeve vendore. Sipas tij, kërkuesi, me urdhrin nr. 151, datë 17.6.2019, ka urdhëruar ndërprerjen e veprimtarisë zgjedhore të çdo lloji për të gjithë subjektet në territorin e Bashkisë së Vaut të Dejës. Ky urdhër i është dërguar Komisariatit të Policisë së Vaut të Dejës me qëllim ndërprerjen e funksionimit të KZAZ-së nr. 6 dhe KQZ-së, me qëllim tërheqjen e materialeve zgjedhore nga KZAZ-ja nr. 6. Ai e ka nxjerrë këtë urdhër pa marrë parasysh rezolutën e Kuvendit, qëndrimin e KQZ-së dhe vendimin nr. 12/2019, të Kolegjit Zgjedhor, sipas të cilave zgjedhjet vendore do të zhvilloheshin në datën 30.6.2019. Gjithashtu, nga aktet e administruara nuk rezulton që kërkuesi të ketë marrë masa administrative ndaj punonjësve të Bashkisë së Vaut të Dejës, të cilët kanë bllokuar në disa raste akse të rëndësishme rrugore ose janë përfshirë në ngjarjen e ndodhur në KZAZ-në nr. 6. Këto veprime, të cilat kanë qenë në kundërshtim me vendimmarrjen e institucioneve shtetërore, kanë dëmtuar rëndë imazhin e organit të zgjedhur vendor, sepse janë të lidhura me përmbushjen e rregullt të detyrës nga ana e kërkuesit.

53. Në lidhje me këtë pretendim të kërkuesit dhe prapësimet e subjektit të interesuar, Gjykata, gjatë votimit të çështjes, nuk arriti shumicën e të gjithë anëtarëve të saj të kërkuar nga dispozitat përkatëse kushtetuese dhe ligjore. Sipas nenit 133, pika 2, të Kushtetutës, Gjykata merr vendim përfundimtar me shumicën e të gjithë anëtarëve të saj, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj. Kjo dispozitë kushtetuese është reflektuar edhe në përmbajtjen e nenit 72, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, sipas të cilit vendimet e saj merren me shumicën e votave të të gjithë anëtarëve të saj dhe abstenimi nuk lejohet. Për rrjedhojë, në bazë të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, në kushtet kur nuk është formuar shumica e kërkuar prej 5 votash, ky pretendim konsiderohet i rrëzuar[1].

[1] Votuan pro pranimit të këtij pretendimi gjyqtarët: Vitore Tusha, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja dhe

54. Si përfundim, Gjykata, bazuar në analizën e të gjitha pretendimeve të kërkuesit, vlerëson se kërkesa e tij duhet pranuar në objektin e saj, pasi është cenuar procesi i rregullt ligjor në aspektet e së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u dëgjuar, si dhe të standardit të arsyetimit të vendimit.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 115, pika 2, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 e vijues, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr. 445, datë 28.6.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Zef Hila".

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 10.5.2021.
Shpallur më 4.6.2021.

Kryetare: Vitore Tusha
Anëtarë: Përparim Kalo, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja
Anëtarë pjesërisht kundër: Fiona Papajorgji, Elsa Toska
Anëtarë kundër: Altin Binaj

MENDIM PAKICE

1. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën për përfundimin e arritur në këtë çështje lidhur me pretendimin për cenimin e standardit të arsyetimit, e çmojmë të rëndësishme të shprehemi me mendim pakice.

2. Shumica ka arsyetuar, ndër të tjera, se në relacionin shoqërues të vendimit të kundërshtuar, përveçse paraqiten si referenca neni 62, shkronja "a", i ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore" *(ligji nr. 139/2015)*, si dhe nenet 100 dhe 115 të Kushtetutës, nuk evidentohen elementet e tjera të arsyetimit, që kërkohen nga neni 100 i KPA-së, e, në mënyrë të veçantë nuk jepet shpjegim i mjaftueshëm pse veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe, ajo që është më e rëndësishmja, mungon shpjegimi pse Këshilli i Ministrave ka përdorur diskrecionin për t'u mbledhur dhe vendosur në kushtet e urgjencës (...) Procesi i shkarkimit fillon me fazën e vlerësimit të shkeljeve nga ministri i Brendshëm dhe përfundon me vendimmarrjen e Këshillit të Ministrave që miraton vlerësimin e bërë nga ministri i Brendshëm. Janë pikërisht këto dy organe të cilat realizojnë, sipas kompetencave përkatëse të tyre, në mënyrë të pashkëputur, procesin administrativ të shkarkimit nga detyra të organeve vendore. Për arsye të rolit të rëndësishëm që ato kanë, duhet të respektojnë me rigorozitet standardet e procesit të rregullt ligjor. Në këtë kontekst, relacioni i ministrit të Brendshëm duhet të hartohet duke mbajtur në konsideratë kërkesat e arsyetimit të aktit administrativ të përcaktuara nga KPA-ja, sidomos vlerësimin se përse faktet përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve nga organi i zgjedhor vendor. Këto elemente nuk janë të pasqyruara në mënyrë të mjaftueshme në relacionin e ministrit të Brendshëm, mbi të cilin është bazuar edhe vendimi nr. 445/2019, i Këshillit të Ministrave, për shkarkimin e kërkuesit. Ndërsa, lidhur me urgjencën e rastit, vlerësimi i së cilës, siç shpjegoi subjekti i interesuar, është në përgjegjësinë dhe diskrecionin e tij, relacioni nuk përmban asnjë të dhënë, duke mos respektuar detyrimin e përcaktuar shprehimisht nga neni 100, pika 1, shkronja "ç", i KPA-së. Kjo e metë e arsyetimit të aktit është me rëndësi të veçantë, pasi zhvillimi i procedurës urgjente është përdorur nga subjekti i interesuar edhe për t'u shmangur nga detyrimi për të njoftuar dhe dëgjuar kërkuesin, siç u arsyetua më lart në këtë vendim *(shih paragrafët 43 dhe 44, të vendimit)*.

3. Nga relacioni i ministrit të Brendshëm "Për projektvendimin "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Zef Hila"", bashkëshoqërues i procesit të vendimmarrjes dhe shkarkimit, konstatohet se ai përmban:

Përparim Kalo. Votuan kundër pranimit gjyqtarët: Elsa Toska, Fiona Papajorgji dhe Altin Binaj.

3.1 - qëllimin e synuar nga ky projektvendim, konkretisht shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Z.H.;

3.2 - bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur propozimi për shkarkimin e tij (neni 62, pika "a", i ligjit nr. 139/2015);

3.3 - faktet konkrete, në lidhje me veprimet e kundërligjshme të kryera në datën 27.6.2019, në Bashkinë e Vaut të Dejës, për të cilat është vlerësuar përgjegjësia e kryetarit të kësaj bashkie. Kështu, konkretisht, ministri i Brendshëm ka arsyetuar:

"Me datë 24.6.2019, me anë të shkresës nr. 3406, të Bashkisë Vau-Dejës, nënshkruar nga kryetari i kësaj Bashkie Zef Hila, drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Komisariatit të Policisë Vau-Dejës dhe Misionit të OSBE/ODIHR, ndër të tjera, ka bërë më dije se nga data 27 qershor 2019 deri në 2 korrik 2019, në kushtet kur ka një dekret të Presidentit që anulon zgjedhjet, kërkon që ambientet ku ndodhet KZAZ-ja nr. 6 e Bashkisë Vau-Dejës të jetë në dispozicion të qytetarëve për aktivitete të ndryshme artistike, kulturore dhe letrare, apo për tubime që do të organizohen në përputhje me të drejtën kushtetuese të lirisë së tubimit, sipas nenit 47 të Kushtetutës. Nisur nga kjo shkresë dhe e gjithë situata në fushatën zgjedhore në gjithë territorin e Qarkut Shkodër, në bashkitë e saj janë marrë masat për ruajtjen e KZAZ-ve, si para se të vinin materialet zgjedhore edhe në momentin kur janë vendosur në të gjitha KZAZ-të e miratuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Në KZAZ-në nr. 6, të Bashkisë Vau-Dejës, e cila ndodhet e vendosur në palestrën e shkollës së mesme profesionale "Ndre Mjeda", shkollë e cila është në një ambient të hapur dhe e parrethuar në të gjithë hapësirën e saj, nga strukturat e Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër janë rritur masat e sigurisë duke vendosur shtim të forcave policore për ruajtjen e tyre.

Me datë 27.6.2019, në orën 20.00, një grup prej 150–200 personash, të organizuar nga kryetari i Bashkisë Zef Hila, i cili nuk ishte prezent vetë, ka drejtuar dhe ka dërguar njerëzit e tij më të afërt, duke i dërguar drejt ambienteve të KZAZ-së. Ky grup personash drejtohej dhe udhëhiqej nga autoritetet drejtuese dhe përfaqësuesit më të lartë të Bashkisë Vau-Dejës që janë zv./kryetari i Bashkisë Vau-Dejës A. H., sekretari i Bashkisë G. N., kryetari i Njësisë Administrative H. B. N, si dhe shumë punonjës të tjerë të bashkisë. Këta persona pasi bënë një takim formal me shefin e Komisariatit të Policisë Vau-Dejës, në mënyrë të menjëhershme e kanë shtyrë dhe janë sulur drejt punonjësve të tjerë të policisë, ku ka pasur një sulm me veprime aktive, të drejtpërdrejta duke i shtyrë, goditur, me qëllim që t'i largonin dhe të hynin brenda në ambientin e KZAZ-së. Personat kanë hedhur në drejtim të forcave të policisë mjete piroteknike, bomba molotov (shishe me benzinë të lidhura me kapsolla që shpërthejnë dhe kthehen në rrezik potencial për jetën pasi përhapet flaka), ku si pasojë e hedhjes së tyre, 4 punonjës policie kanë mbetur të plagosur. Gjithashtu, kanë hedhur molotov edhe nga dritaret e jashtme të palestrës ku i kanë vënë zjarrin gjithë materialeve zgjedhore që ndodheshin brenda KZAZ-së.

Nga kryerja e veprimeve hetimore rezulton se personat e implikuar dhe personat përgjegjës për këtë ngjarje të rëndë kriminale janë përfaqësuesit kryesorë të bashkisë, si dhe familjarët e afërm të Kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës Zef Hila. Në lidhje me këtë ngjarje midis personave të tjerë zyrtarë të Bashkisë Vau-Dejës është bërë arrestimi i shtetasit A. K. H. (vëllai i kryetarit të Bashkisë), si dhe është shpallur në kërkim shtetasi E. Z. H. (djali i kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës).

Gjithashtu, kryetari i Bashkisë Zef Hila duke mos marrë pjesë në veprime aktive, por duke nxjerrë funksionarët e tjerë të Bashkisë, si zv/kryetarin A. H., Sekretarin e Bashkisë G. N., si dhe të gjithë kryetarët e njësisë vendore dhe punonjës të tjerë të Bashkisë Vau-Dejës, me datë 20.6.2019, ka organizuar bllokimin e rrugës nacionale Lezhë-Shkodër, gjatë vizitës që do të benën autoritetet e larta shtetërore, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të pengonin takimet elektorale.

Me datë 2.5.2019, në protestën e organizuar nga subjekti politik PD, është bllokuar rruga nacionale në aksin Shkodër-Lezhë në Kryebushat dhe të organizuar nga funksionarët e Bashkisë Vau-Dejës, kanë bllokuar këtë aks rrugor.

Gjithashtu, me datë 26.4.2019, gjatë vizitës që do të bënin autoritetet e larta shtetërore, Kryeministri i Republikës së Shqipërisë në qarkun Shkodër në aksin rrugor Vau Dejës – Shkodër, në fshatin Mjedë, po këta persona të lartpërmendur, nën drejtimin e Zef Hilës, kanë tentuar të bllokojnë rrugën.

Sipas informacionit të Policisë së Shtetit, rezulton se personat e implikuar dhe personat përgjegjës për këto ngjarje të rënda kriminale janë përfaqësuesit kryesorë të bashkisë, si dhe familjarë të afërm të kryetarit të bashkisë Vau-Dejës, z. Zef Hila.

Veprimet e përsëritura të kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës janë në kapërcim të kompetencave dhe në shkelje të hapur të ligjit. Tentativat e tij për të prishur procesin

zgjedhor përmes angazhimit të përsëritur të punonjësve të bashkisë në bllokimin e dhunshëm të qarkullimit rrugor në akse kombëtare dhe në sulmet e organizuara kundër KZAZ e bëjnë shkarkimin e z. Zef Hila një lëvizje të pashmangshme.".

4. Po kështu, vendimi nr. 445/2019, i Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 100 dhe 115, pika 1, të Kushtetutës dhe nenin 62, shkronja "a", të ligjit nr. 139/2015, duke reflektuar të gjithë bazën ligjore të nevojshme për vendimmarrjen.

5. Nga sa më lart, ne, gjyqtarët në pakicë, vlerësojmë se të dhënat e mësipërme e plotësojnë standardin e një arsyetimi të mjaftueshëm në raport me qëllimin dhe funksionin që ka ky standard, sikundër janë: e drejta e funksionarit për të marrë dijeni për të gjitha arsyet e shkarkimit, e drejta për ankim efektiv në Gjykatën Kushtetuese, kontrolli efektiv dhe substancial i Gjykatës Kushtetuese për standardin e arsyetimit, bazuar në argumentet e dhëna në këtë proces, si dhe detyrimi për transparencë dhe vëzhgimi publik i veprimtarisë së Këshillit të Ministrave për të gjithë të interesuarit që duan të marrin dijeni për procese të kësaj natyre.

6. Nga ana tjetër, ashtu siç pranon edhe shumica, në seancën gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës nga Gjykata Kushtetuese, subjekti i interesuar ka parashtruar si argument shtesë, edhe se kërkuesi ka vepruar për pengimin e procesit zgjedhor vendor të caktuar në datën 30.6.2019, duke shkelur në këtë mënyrë nenin 109 të Kushtetutës, për periodicitetin e zgjedhjeve vendore, si dhe nuk ka marrë parasysh detyrimin e bashkisë për zbatimin e vendimeve të KQZ-së dhe të Kolegjit Zgjedhor për datën e zgjedhjeve *(shih procesverbalin e seancës gjyqësore).*

7. Në këtë drejtim, theksojmë se roli i Gjykatës Kushtetuese, si gjykatë kontrolli ndaj vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave është jo vetëm garantimi i të drejtave kushtetuese të kandidatit të shkarkuar nga funksioni drejtues i organit të qeverisjes vendore, por njëkohësisht edhe garantimi i respektimit të nenit 13 të Kushtetutës, për ushtrimin e qeverisjes sipas parimit të autonominë vendore, i cili njeh jo vetëm pavarësinë e organeve të qeverisjes vendore, por njëkohësisht edhe përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre. Kjo Gjykatë këtë detyrë do ta kryente për shkak të funksionit themelor dhe të posaçëm në këtë lloj procesi, ku ajo nuk do të duhej të garantonte vetëm të drejtat e funksionarit të shkarkuar, por edhe interesin publik që kjo detyrë mbart, në drejtim të mbrojtjes së vlerave, si përgjegjësia dhe llogaridhënia e këtyre funksionarëve në ushtrim të detyrës, në përputhje me neni 13 të Kushtetutës.

8. Nisur nga sa më lart, Gjykata kontrollon vlefshmërinë e aktit të shkarkimit, si nga pikëpamja e faktit, ashtu edhe nga pikëpamja e interpretimit dhe zbatimit të ligjit material e procedural. Pra, në këto raste, Gjykata Kushtetuese heton dhe gjykon në themel çështjen, ashtu siç do të vepronte një gjykatë e sistemit gjyqësor të zakonshëm. Gjatë këtij gjykimi kjo gjykatë, kontrollon të gjitha standardet e parashikuara nga Kushtetuta në lidhje me këtë proces.

9. Për rrjedhojë, vlerësojmë se argumenti shtesë i paraqitur nga subjekti i interesuar, pavarësisht se nuk përbën pjesë të argumenteve në relacionin e ministrit të Brendshëm, dhe nuk është cilësuar në përmbajtje të vendimit nr. 445/2019, të Këshillit të Ministrave, përmes të cilit është vendosur shkarkimi i kërkuesit nga detyra e kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, nuk mund të mos merret parasysh për efekt të plotësimit të standardit të arsyetimit të këtij vendimi.

10. Duke iu kthyer qëndrimit të shumicës, ajo shprehet se në relacionin shoqërues të vendimit të kundërshtuar, përveçse paraqitet si referencë neni 62, shkronja "a", i ligjit nr. 139/2015, si dhe nenet 100 dhe 115 të Kushtetutës, mungojnë elementet e tjera të arsyetimit, që kërkohen nga neni 100 i KPA-së, në mënyrë të veçantë nuk jepet shpjegimi pse veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve dhe ajo që është më e rëndësishmja, shpjegimi se përse Këshilli i Ministrave ka përdorur diskrecionin për t'u mbledhur dhe vendosur në kushtet e urgjencës. *(prg. 43 i vendimit*).

11. Në lidhje me këto argumente të shumicës, vlerësojmë se: - së pari, shpjegimet se pse veprimet e kërkuesit përbëjnë shkelje të rëndë të Kushtetutës ose të ligjeve, nuk mungojnë. Konkretisht në këtë aspekt, në relacionin e ministrit të Brendshëm, parashikohet: *"Veprimet e përsëritura të kryetarit të Bashkisë Vau-Dejës janë në kapërcim të kompetencave dhe në shkelje të hapur të ligjit. Tentativat e tij për të prishur procesin zgjedhor përmes angazhimit të përsëritur të punonjësve të bashkisë në bllokimin e dhunshëm të qarkullimit rrugor në akse kombëtare dhe në sulmet e organizuara kundër KZAZ e bëjnë shkarkimin e z. Zef*

Hila një lëvizje të pashmangshme."; - së dyti, është e vërtetë që KPA-ja, në nenin 100, pika 1, shkronja "ç", kërkon që, në rastin e diskrecionit, akti të përmbajë shpjegimin se pse diskrecioni është përdorur në mënyrën e caktuar, sikundër edhe shumica e analizon *(shih paragrafin 44 të vendimit)*. Megjithatë, në vlerësimin e pakicës, mosndjekja në mënyrë rigoroze dhe strikte e standardit të arsyetimit sipas nenit 100, pika 1, shkronja "ç" , ku do të duhej të arsyetohej edhe urgjenca, nuk sjell asnjë cenim të mjaftueshmërisë së standardit të arsyetimit, i cili lidhet thelbësisht me detyrimin për arsyetim të elementëve të kërkuar nga shkronjat "a" (shpjegimi i situatës faktike mbi të cilën është marrë akti), "b" (shpjegimin e përmbledhur të rezultatit të hetimit administrativ dhe të vlerësimit të provave), dhe "c" (bazën ligjore të aktit dhe një shpjegim pse kushtet ligjore për zbatimin e tij plotësohen në këtë rast), të nenit 100, që Këshilli i Ministrave i ka respektuar. Për më tepër, që ky arsyetim, sikundër theksuam dhe më lart, është plotësuar edhe me argumente shtesë në seancën gjyqësore para Gjykatës Kushtetuese.

12. Edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut *(GJEDNJ)* në këtë drejtim ka theksuar se një shqyrtim i çështjes nga një autoritet administrativ, i cili në disa aspekte nuk përputhet me kriteret e kërkuara të nenit 6, nuk mund të konsiderohet shkelje e Konventës, për sa kohë që vendimmarrja e këtij organi shqyrtohet nga një organ gjyqësor me "juridiksion të plotë" dhe që garanton elementet e kërkuara të nenit 6/1 të KEDNJ-së *(shih vendimet e GJEDNJ-së, Albert de la Compte kundër Belgjikës, kërkesat nr. 7299/75 dhe 7496/76, 3 shkurt 2009, § 29; Sigma Radio Television Ltd kundër Qipros, kërkesat nr. 32181/04 dhe 35122/05, 21 korrik 2011, § 151).*

13. Për të gjitha sa më lart, vlerësojmë se në rastin konkret nuk ka pasur shkelje të standardit të arsyetimit nga Këshilli i Ministrave për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës.

Anëtarë: Altin Binaj, Elsa Toska

MENDIM PAKICE

1. Në përfundim të gjykimit kushtetues të kërkesës së paraqitur nga Zef Hila, me objekt: "*Shfuqizimi i vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 445, datë 28.6.2019, "Për shkarkimin nga detyra të kryetarit të Bashkisë së Vaut të Dejës, z. Zef Hila", si i papajtueshëm me Kushtetutën*"", Gjykata ka vendosur pranimin e kërkesës me arsyetimin se në procesin e shkarkimit të kërkuesit nuk janë respektuar në nivelin minimal e drejta për t'u njoftuar dhe e drejta për t'u dëgjuar (*shih paragrafin 37 të vendimit*) dhe se vendimi i Këshillit të Ministrave për shkarkimin nga detyra të kërkuesit nuk respekton standardin e arsyetimit (*shih paragrafin 45 të vendimit*).

2. Për arsye se nuk ndajmë të njëjtin qëndrim me shumicën lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje, vetëm për sa i përket pretendimit të kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u njoftuar dhe për t'u dëgjuar, e çmojmë të rëndësishme të shprehim argumentet mbi të cilat mbështesim mendimin tonë në pakicë.

3. Kërkuesi ka pretenduar, mes të tjerash, cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar për arsye se nga ana e Këshillit të Ministrave nuk është bërë asnjë përpjekje për të zgjidhur mosmarrëveshjen dhe nuk është kërkuar informacion ose sqarim prej tij lidhur me shkeljet e pretenduara. Kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të dëgjohej dhe të paraqiste prova, si dhe nuk i janë vënë në dispozicion aktet e domosdoshme të procesit të shkarkimit (akti i propozimit, relacioni i ministrit, procesverbali i mbledhjes së Këshillit të Ministrave, vendimi i shkarkimit). Sipas tij, procesi i shkarkimit është bërë me urgjencë dhe nuk janë respektuar rregullat procedurale të ligjit nr. 9000/2003 dhe të rregullores së Këshillit të Ministrave.

4. Subjekti i interesuar ka parashtruar se vendimmarrja e Këshillit të Ministrave, në rastin konkret, ka qenë urgjente për shkak të situatës së krijuar në Bashkinë e Vaut të Dejës dhe cenimit të interesit publik. Procedura për shqyrtimin dhe miratimin e VKM-së nr. 445/2019 u është nënshtruar të gjitha rregullave të parashikuara nga ligji nr. 9000/2003 dhe Rregullorja për zhvillimin e një mbledhjeje të jashtëzakonshme, duke pasur parasysh edhe rastet ku sipas ligjit përjashtohet mundësia e palëve për t'u shprehur.

Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, vendimi i shkarkimit është publikuar në Fletoren Zyrtare në datën 2.7.2019 dhe në datën 19.7.2019, i është dërguar Bashkisë së Vaut të Dejës. Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë kërkesë për të kërkuar relacionin shoqërues të vendimit të shkarkimit.

5. Fillimisht, duam të nënvizojmë faktin se bashkohemi me parimet e theksuara nga shumica, për sa i përket rëndësisë së të drejtës për një proces të rregullt ligjor, të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës, jo vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter disiplinor administrativ (shih paragrafin 26 të vendimit). Në këtë kuptim, Gjykata, në jurisprudencën e saj, ka theksuar se çdo organ i pushtetit publik, gjatë ushtrimit të funksionit të tij kushtetues e ligjor, është i detyruar të respektojë standardet e gjithëpranuara demokratike, të cilat kanë gjetur pasqyrimin e tyre në Kushtetutë. Njohja paraprake e personit, ndaj të cilit kërkohet të merret masa e shkarkimit, me materialet që e ngarkojnë atë me përgjegjësi, respektimi i së drejtës për t'u dëgjuar dhe mbrojtur, si me anën e dhënies së sqarimeve paraprake ashtu edhe gjatë shqyrtimit të çështjes, janë disa nga elementet bazë që garantojnë të drejtën kushtetuese të cilitdo për një proces të rregullt, si një e drejtë themelore (*shih vendimet nr. 29, datë 27.6.2013; nr. 37, datë 25.7.2013; nr. 76, datë 25.4.2002, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Po në këtë këndvështrim, Gjykata ka pohuar se e drejta për t'u dëgjuar, si pjesë e së drejtës së mbrojtjes, garantohet edhe në procesin administrativ përpara çdo organi, pavarësisht nga instanca dhe rëndësia e tij. Kjo realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes së vetë individit në proces dhe nëpërmjet parashtrimit të argumenteve prej tij ose avokatit të zgjedhur *(shih vendimin nr. 29, datë 27.6.2013, të Gjykatës Kushtetuese)*.

7.Nga ana tjetër, garancitë që ofrohen gjatë procedimit administrativ janë të parashikuara edhe nga KPA-ja (e miratuar me ligjin nr. 44/2015), i cili në nenin 33 përcakton se palë në procedurën administrative është edhe çdo person ndaj të cilit ka filluar procedura administrative ose të cilit i drejtohet, apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative. Ndërsa neni 88 i KPA-së parashikon mënyrën e ushtrimit të së drejtës për t'u dëgjuar, e cila bëhet në çdo formë të përshtatshme dhe brenda afatit të përcaktuar nga organi publik.

8. Megjithatë, procedimi administrativ nuk zhvillohet përherë në prani të palëve të interesuara dhe jo çdo herë këto të fundit mund të shprehen për procedimin. Neni 89 i KPA-së parashikon rastet e përjashtimit nga e drejta për t'u dëgjuar, pra kur procedura administrative mund të mbyllet pa njoftuar dhe pa i dhënë mundësinë palës të dëgjohet, mes të cilave edhe kur: a) marrja e vendimit përfundimtar është urgjente, për shkak të dëmit që mund t'i shkaktohet, për shkak të vonesës, interesit publik. Sipas kësaj dispozite ekzistenca e urgjencës, e cila konsiston në dëmin që vjen nga vonesa në interesin publik, është një prej rasteve që justifikon mosrespektimin e së drejtës për t'u dëgjuar.

9. Duke pasur parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese gjatë shqyrtimit të ankimit sipas nenit 115 të Kushtetutës, si edhe parimet themelore të procedimit administrativ të sanksionuara në KPA, vlerësojmë se në rastin konkret procedura e shkarkimit është zhvilluar në kushtet e urgjencës, çka ka passjellë që kërkuesit nuk i është dhënë mundësia të realizojë të drejtën për t'u dëgjuar.

10. Ashtu sikurse është vërejtur edhe nga shumica, relacioni i ministrit të Brendshëm dhe vendimi nr. 445/2019 i Këshillit të Ministrave, për shkarkimin e kërkuesit nga detyra mbajnë të njëjtën datë, konkretisht datën 28.6.2019 (*shih paragrafin 29 të vendimit*). Nisur nga ky fakt shumica ka arritur në përfundimin se procedura e shkarkimit është realizuar brenda 24 orëve, pra nga pikëpamja kohore është karakterizuar nga urgjenca, ndërsa në vijim publikimi i aktit të shkarkimit është zhvilluar me procedurë normale (*shih paragrafin 30 të vendimit*). Ky fakt mbështetet edhe nga parashtrimet e subjektit të interesuar, i cili ka shpjeguar se vendimi i shkarkimit është marrë në një mbledhje të jashtëzakonshme të Këshillit të Ministrave dhe në kushtet e urgjencës për shkak të situatës së krijuar në Bashkinë e Vaut të Dejës. Nga aktet e dosjes dhe rrethanat faktike nuk rezulton që kërkuesi të jetë njohur paraprakisht me shkeljet të cilat i janë atribuuar, në mënyrë që, në një ballafaqim procedural, të mund të paraqiste kundërshtimet e tij ndaj këtyre shkeljeve.

11. Shumica ka klasifikuar në 2 grupe rrethanat e situatës faktike që i janë atribuuar kërkuesit gjatë procedurës së shkarkimit nga detyra. Grupi i parë përmbledh veprimet e kryera nga kërkuesi në cilësinë e kryetarit të bashkisë, konkretisht urdhri për ndërprerjen e veprimtarisë zgjedhore, datë 17.6.2019 dhe aktet e tjera të nxjerra në datën 18.6.2019, për zbatimin e këtij urdhri, kurse grupi i dytë i fakteve përmbledh veprimet me natyrë penale, të cilat janë kryer në datën 27.6.2019, konkretisht, dëmtimi me dashje, me anë të zjarrvënies të materialeve zgjedhore dhe kundërshtimi i policisë. Ajo ka arritur në përfundimin se grupi i parë i fakteve edhe pse janë veprime të lidhura me funksionin e kërkuesit si organ i qeverisjes vendore, nuk e justifikojnë urgjencën dhe përjashtimin nga e drejta për t'u dëgjuar, ndërsa për grupin e dytë kompetenca e ndërhyrjes urgjente i takon Policisë së Shtetit dhe prokurorisë (*shih paragrafin 35 të vendimit*).

12. Në vlerësimin tonë, në ndryshim nga sa konkludon shumica, në rastin konkret ndodhemi në një prej rasteve përjashtimore të parashikuara nga neni 89 i KPA-së, pasi, bazuar në aktet e administruara gjatë këtij gjykimi, rezultojnë një sërë veprimesh dhe mosveprimesh edhe të kryetarit të bashkisë, para dhe gjatë datës 27.6.2019, të cilat e rënduan situatën e rendit dhe të sigurisë publike në territorin e administruar prej tij gjatë ushtrimit të këtij funksioni.

13. Këto veprime dhe mosveprime nuk janë kryer vetëm në një episod dhe në një ditë të vetme, por ato janë kryer sipas një kronologjie kohore, që vetëm sa ka kulmuar edhe me kryerjen e veprimeve të paligjshme të natyrës juridiko-penale në ngjarjen e datës 27.6.2019, në KZA-në nr. 6, të Bashkisë së Vaut të Dejës.

14. Është pikërisht për shkak të kategorizimit të grupfakteve, sikurse ka konstatuar edhe shumica, kronologjisë dhe pasojave konkrete që ato fakte kanë sjellë, arsyeja për të cilën mendojmë se situata e rendit dhe sigurisë publike, si dhe e mbrojtjes së pronës publike në bashkinë e drejtuar nga kërkuesi janë cenuar rëndë edhe për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të këtij të fundit. Këto fakte justifikojnë bindjen e Këshillit të Ministrave se ajo situatë mund të rëndohej edhe më tej, duke mbajtur në konsideratë rrethana objektive të tilla si: i. kërkuesi kishte kërkuar pezullimin e procesit zgjedhor; ii. kërkuesi kishte kërkuar boshatisjen e KZAZ-së nga materialet zgjedhore; iii, nuk kishte marrë asnjë masë ndaj vartësve të tij të bashkisë së implikuar edhe gjatë orarit të punës në veprime të mëparshme në cenim të rendit publik; iv. nuk aktivizoi asnjë nga strukturat në varësi të tij në mbrojtje të pronës publike në administrim prej tij.

15. Në vlerësimin tonë, në procedurën administrative të shkarkimit të kryetarit të bashkisë, ushtrimi i kompetencës nga autoritetet politike shtetërore karakterizohet nga një hapësirë vlerësimi diskrecionale, e cila, nisur edhe nga roli i rëndësishëm që mbart detyra e kryetarit të bashkisë, vë në baraspeshë vlerën e përfaqësimit të organeve të zgjedhura vendore me përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e tyre. Në rastin në shqyrtim, natyra e veprimeve dhe mosveprimeve të kërkuesit, mënyra se si janë zhvilluar dhe kanë precipituar ngjarjet janë të tilla që krijojnë premisa serioze për shkaktimin e një dëmi që mund të vijë nga vonesa në interesin publik. Ky i fundit, në rastin në shqyrtim, lidhet drejtpërdrejt me ruajtjen e rendit dhe të sigurisë publike, garantimin e pronës publike dhe të lëvizjes së lirë të qytetarëve.

16. Edhe pse mekanizmi i ndërhyrjes për faktet e natyrës penale, sikurse arsyeton edhe shumica (*shih paragrafin 36 të vendimit*), u përket organeve të tjera (Policisë së Shtetit, prokurorisë dhe gjykatave) në bazë të rregullave të Kodit të Procedurës Penale, ky i fundit përcakton procedura dhe afate rigoroze që duhet të respektohen nga organet e lartpërmendura, të tilla që nëse do të aplikoheshin në rastin konkret, mendoj se nuk do të mund të siguronin parandalimin e rëndimit të situatës në drejtim të ruajtjes së rendit dhe sigurisë publike, si dhe të garantimit të pronës publike dhe lëvizjes së lirë të qytetarëve në kohë reale.

17. Po në këtë drejtim, pretendimi i kërkuesit se urgjenca nuk justifikohej në rastin konkret, sepse VKM-ja objekt shqyrtimi mund të pezullohej në efektet e saj nëse ushtrohej ankim, sipas nenit 115, të Kushtetutës, në Gjykatën Kushtetuese, është i pabazuar, sepse gjendja e urgjencës në rastin konkret lidhet vetëm me elementin faktik të dëmit që mund t'i shkaktohet interesit publik në momentin kur është marrë vendimi i shkarkimit dhe është indiferent ndaj situatës juridike të perspektivës.

18. Megjithatë, për sa më lart, në kushtet kur është aplikuar përjashtimi i parashikuar nga neni 89 i KPA-së, Këshilli i Ministrave kishte detyrimin të arsyetonte në vendimin e tij për shkaqet që lidhen me urgjencën, pra me dëmin në interesin publik për shkak të vonesës, të cilat justifikonin kufizimin e së drejtës për t'u dëgjuar, si element i së drejtës për t'u mbrojtur. Për këtë arsye e gjejmë të drejtë dhe bashkohemi me qëndrimin e shumicës, e cila ka vlerësuar se vendimi i shkarkimit të Këshillit të Ministrave ka cenuar standardin e arsyetimit të vendimit.

Anëtarë: Altin Binaj, Fiona Papajorgji

VENDIM
Nr. 28, datë 2.6.2021

PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK, PËR ZOTËRIMIN NGA SHOQËRIA "EUROSIG" SHA TË 21.02 PËR QIND TË KAPITALIT AKSIONAR TË BANKËS SË BASHKUAR TË SHQIPËRISË SHA

Në bazë dhe për zbatim të shkronjës "e", të nenit 43, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; të shkronjës "h", të pikës 1, të nenit 24, dhe të nenit 25, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar; si dhe të rregullores "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së bankave dhe të degëve të bankave të huaja në Republikën e Shqipërisë", miratuar me vendimin nr. 14, datë 11.3.2009, të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, të ndryshuar; me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraprak për zotërimin e 21.02 për qind të aksioneve, me të drejtë vote të kapitalit aksionar të Bankës së Bashkuar të Shqipërisë sh.a., nga shoqëria "Eurosig" sh.a.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gent Sejko

UDHËZIM
Nr. 1, datë 2.6.2021

PËR MËNYRËN E LLOGARITJES SË FIKSIT TË KURSIT TË KËMBIMIT TË LEKUT NË BANKËN E SHQIPËRISË

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "b" dhe "c", si dhe të neneve 59 dhe 60, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të Departamentit të Operacioneve Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

UDHËZON:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i mënyrës së llogaritjes së fiksit për efekte të përftimit të një niveli të vetëm reference të kursit të këmbimit të lekut ndaj monedhave të huaja, i cili më pas mund të përdoret nga të interesuarit për qëllime statistikore, krahasuese, kontabilizuese, vlerësuese dhe tregtuese.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:

a) "Fiksi" – është kursi zyrtar i këmbimit i disa prej monedhave të huaja kundrejt lekut, që përfaqësohet nga një vlerë e vetme dhe publikohet nga Banka e Shqipërisë;

b) "Mesatarja e çmimit në blerje (*bid price*)" – është mesatarja e thjeshtë aritmetike e çmimeve të kuotuara nga bankat, me të cilat ato janë të

gatshme të blejnë një sasi të monedhës së huaj kundrejt lekut. Ajo llogaritet për kurset e blerjes së euros dhe për kurset e blerjes së dollarit amerikan;

c) "Mesatarja e çmimit në shitje (*ask price*)" – është mesatarja e thjeshtë aritmetike e çmimeve të kuotuara nga bankat, me të cilat ato janë të gatshme të shesin një sasi të monedhës së huaj kundrejt lekut. Ajo llogaritet për kurset e shitjes së euros dhe për kurset e shitjes së dollarit amerikan;

d) "DOM" – është Departamenti i Operacioneve Monetare në Bankën e Shqipërisë;

e) "Pjesëmarrës" - janë ato banka, të përzgjedhura nga DOM-i, sipas nenit 3, pika 1, të këtij udhëzimi, të cilat ofrojnë kurset e këmbimit të blerjes dhe të shitjes së euros dhe dollarit amerikan kundrejt lekut, në bazë të të cilave llogaritet fiksi i euros dhe i dollarit amerikan kundrejt lekut;

f) "Monedha e referencës" – është ajo monedhë, kursi fiks i së cilës llogaritet drejtpërdrejtë nga kuotimet e pjesëmarrësve në procesin e fiksit. Njëkohësisht, kursi fiks i kësaj monedhe shërben për llogaritjen e kursit fiks të këmbimit për monedha të tjera të përfshira në fiks;

g) "Kuotimi standard" – është shfaqja e njëkohshme e çmimit në blerje dhe çmimit në shitje për shumën 100 mijë euro dhe 100 mijë dollarë amerikan nga pjesëmarrësi në fiks;

h) "Banka" - është banka tregtare e licencuar sipas legjislacionit bankar.

Neni 3
Pjesëmarrësit

1. Pjesëmarrës në procesin e fiksit janë 10 banka që operojnë brenda vendit dhe kanë vëllimin më të lartë të veprimeve në treg ndërbankar në 24 muajt e fundit. DOM-i rishikon listën e pjesëmarrësve në procesin e fiksit, të paktën një herë në vit.

2. Banka e Shqipërisë publikon në faqen e saj zyrtare të internetit listën e bankave pjesëmarrëse në procesin e fiksit dhe DOM-i njofton me shkrim secilën prej bankave pjesëmarrëse.

3. Banka e Shqipërisë, në rastet kur nuk siguron informacionin e kërkuar nga bankat të cilat janë pjesëmarrëse në procesin e përcaktimit të fiksit, në përputhje me kriterin e pikës 1, e përcakton atë duke u bazuar në informacionin e marrë nga jo më pak se 5 banka.

4. Banka e Shqipërisë, në rast se nuk ka informacionin e kërkuar nga pjesëmarrësit në procesin e përcaktimit të fiksit, në përputhje me pikat 1 dhe 3, përcakton kursin zyrtar të këmbimit të njëjtë me atë të ditës së punës paraardhëse.

Neni 4
Dhënia e informacionit nga bankat

1. Bankat i komunikojnë kuotimet standarde të dollarit amerikan dhe euros nëpërmjet faqeve të tyre në *Thomson Reuters EIKON*.

2. Nëse për arsye teknike një gjë e tillë është e pamundur, bankat i japin kurset e tyre jo të standardizuara nëpërmjet *Refinitiv FX TRADING, Bloomberg,* postës elektronike ose telefonit. Në rastet kur kurset e bankave merren me postë elektronike ose telefon, ato duhet të konfirmohen më pas në *Refinitiv FX Trading*, menjëherë sapo një gjë e tillë të jetë e mundur.

3. Bankat, në intervalin e kohës së përcaktuar për llogaritjen e fiksit, publikojnë kuotimet standarde më të fundit në faqet e tyre në *Thomson Reuters Eikon.*

Neni 5
Koha e llogaritjes së fiksit dhe marrja e informacionit

1. Si rregull, llogaritja e fiksit bëhet çdo ditë pune nga DOM-i, në intervalin kohor 11:30–12:00.

2. Duke filluar nga ora 11:30, DOM-i verifikon nëse bankat kanë paraqitur në faqen e tyre në *Reuters* kuotimet standarde më të fundit, nëpërmjet identifikimit të datës dhe orës së vlefshmërisë së kurseve të këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros, me të cilin ato janë të gatshme të tregtojnë në tregun ndërbankar.

3. Vlerat e kursit të këmbimit të euros dhe dollarit amerikan kundrejt lekut, të secilës prej bankave, si dhe vlerat e monedhave të listuara në nenin 6, pikat 5 dhe 6, të këtij udhëzimi kundrejt dollarit amerikan, merren nga një aplikacion i *Thomson Reuters Eikon*, i cili automatikisht

regjistron këto vlera në momentin e llogaritjes së fiksit.

Neni 6
Përpunimi i informacionit

1. Dollari amerikan është valuta e referencës. Kursi i këmbimit të lekut kundrejt valutave të tjera llogaritet në bazë të raporteve të valutave, me përjashtim të euros, me valutën e referencës në tregun ndërkombëtar.

2. Në fashën kohore të përcaktuar, DOM-i sigurohet që të përditësohen të dhënat automatike nga aplikacioni, i cili i rendit kurset sipas rendit zbritës, duke nisur nga vlera më e lartë. Pasi përjashton dy vlerat më të ulëta dhe të larta të këmbimit të dollarit amerikan dhe euros kundrejt lekut, llogaritet vlera mesatare e kuotimeve të mbetura për të dyja këto monedha. Vlerat që përftohen përfaqësojnë fiksin e kursit të këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan dhe euros.

3. Paralelisht me llogaritjen e fiksit, sipas pikës 2 të këtij neni, llogaritet edhe mesatarja e kuotimeve në blerje dhe mesatarja e kuotimeve në shitje të bankave, për monedhat e euros dhe dollarit amerikan. Për përllogaritjen e këtyre mesatareve përdoret metoda e mesatares së thjeshtë aritmetike e të gjitha kuotimeve.

4. Me përftimin e vlerës së fiksit të kursit të këmbimit të lekut kundrejt valutës së referencës si më sipër, llogariten raportet e këmbimit të lekut kundrejt valutave të tjera, sipas raporteve të tyre në tregun ndërkombëtar kundrejt dollarit amerikan në momentin e llogaritjes së fiksit.

5. Llogaritja e fiksit kryhet çdo ditë pune për: dollarin amerikan, euron, jenin japonez, paundin britanik, frangën zvicerane, dollarin australian, dollarin kanadez, koronën suedeze, koronën norvegjeze, koronën daneze, lirën turke, juanin kinez (*onshore*), juanin kinez (*offshore*) dhe njësinë monetare të Fondit Monetar Ndërkombëtar. Në çdo ditë pune llogaritet gjithashtu fiksi për këto metale të çmuara: ar (për 1 onc) dhe argjend (për 1 onc).

6. Me frekuencë 15 ditore, në ditën e mesit dhe të fundit të punës të çdo muaji, llogaritet fiksi për: leva bullgare, forinta hungareze, rubla ruse, kuna kroate, korona çeke dhe dinari maqedonas. Për llogaritjen e kursit zyrtar të këmbimit të të gjitha monedhave të përmendura në këtë pikë, si valutë reference përdoret kursi i dollarit amerikan me lekun.

7. Nëse gjykohet e nevojshme, si rezultat i zhvillimeve në tregun e brendshëm të këmbimeve valutore, valutat për të cilat llogaritet fiksi me frekuencë ditore ose më të rrallë, mund të shtohen ose të pakësohen. Propozimi për shtimin ose pakësimin e monedhave bëhet nga DOM-i dhe miratohet nga Administratori Përgjegjës.

8. Në rastet kur pjesëmarrëse në procesin e fiksit janë më pak se 5 banka, siç parashikohet në nenin 3, pika 3, të këtij udhëzimi, fiksi llogaritet si mesatare e thjeshtë aritmetike e çmimeve në blerje dhe në shitje, pa përjashtuar dy vlerat më të ulëta dhe të larta të këmbimit të dollarit amerikan dhe euros kundrejt lekut.

Neni 7
Publikimi i fiksit

1. Banka e Shqipërisë llogarit dhe publikon fiksin, si dhe vlerën mesatare të çmimeve të blerjes (*bid price*) dhe të shitjes (*ask price*) për monedhat e euros dhe dollarit amerikan çdo ditë pune.

2. Me përfundimin e procesit të llogaritjes së kursit zyrtar të këmbimit, jo më vonë se ora 12:30, hidhen të dhënat e fiksit të ri të llogaritur, në faqen e Bankës së Shqipërisë në *Thomson Reuters Eikon*, në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë, si dhe në sistemin automatik që përdoret në Bankën e Shqipërisë.

3. Nëse, për arsye teknike, një gjë e tillë është e pamundur, informacioni jepet nëpërmjet telefonit, faksit ose postës elektronike, në përgjigje të kërkesave të të interesuarve. Njëkohësisht, DOM-i i dërgon të dhënat pranë departamenteve të Bankës së Shqipërisë, që janë të interesuara.

4. Për monedhën e euros dhe dollarit amerikan, Banka e Shqipërisë publikon vetëm në faqen e saj zyrtare të internetit edhe vlerën mesatare të çmimeve të blerjes (*bid price*) dhe të shitjes (*ask price*).

5. Të interesuarit njihen me kursin zyrtar të këmbimit në faqen zyrtare të internetit të Bankës së Shqipërisë ose kontaktojnë me shkrim Bankën e Shqipërisë. Në varësi të llojit të informacionit të kërkuar, përgjigjja me shkrim e Bankës së Shqipërisë jepet përkatësisht nga:

a) DOM-i, në rast se informacioni i kërkuar ka lidhje me kurset ditore të monedhave të huaja ndaj lekut;

b) Departamenti i Statistikave Financiare, nëse informacioni i kërkuar lidhet me tregues të përpunuar, të tillë si: mesataret mujore e tremujore.

Neni 8
Ruajtja dhe arkivimi

DOM-i ruan të dhënat (faqet dhe bisedat në *Thomson Reuters Eikon*, mesazhet në *e-mail* etj.) për çdo proces të llogaritjes së fiksit në formë elektronike dhe në formë fizike, në përputhje me rregullat e Bankës së Shqipërisë për arkivimin e materialeve.

Neni 9
Veprimet e Bankës së Shqipërisë në rastet e moszbatimit të këtij udhëzimi

1. Në rast se banka/at e përzgjedhur, nuk kuoton kursin e këmbimit, sipas këtij udhëzimi, Guvernatori urdhëron bankën/at për vijimin normal të kuotimit në tregun valutor, në mbështetje të objektivit dytësor të Bankës së Shqipërisë për zhvillimin e sistemit të këmbimeve valutore.

2. Në rastet e mosrespektimit të kuotave ose tregtimit të limituar midis pjesëmarrësve, DOM-i propozon në Komitetin e Zbatimit të Këshillimit dhe Politikës Monetare për përjashtimin e bankës nga veprimet e ndërhyrjes së drejtpërdrejtë dhe me ankand, për një afat deri në 1 vit.

3. Rastet e mosrespektimit të kërkesave të udhëzimit, lidhur me komunikimin në kohën e caktuar dhe për sasi të standardizuara monitorohen çdo ditë, dhe kur ato janë të përsëritura më shumë se 3 herë brenda muajit nga e njëjta bankë, DOM-i informon me shkrim Drejtuesin Ekzekutiv të bankës përkatëse për mosrespektimin e këtyre kërkesave.

Neni 10
Forca madhore

Banka e Shqipërisë nuk mban përgjegjësi për vonesat në publikim apo mospublikim të fiksit, si dhe të vlerës mesatare të çmimeve të blerjes (*bid price*) dhe të shitjes (*ask price*) për monedhat e euros dhe dollarit amerikan, që vijnë nga ndërprerja e punës e shkaktuar nga forca madhore.

Neni 11
Të fundit

1. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen DOM-i, Departamenti i Statistikave Financiare në Bankën e Shqipërisë dhe të gjitha bankat e përzgjedhura në procesin e llogaritjes së fiksit.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi, shfuqizohet vendimi i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë nr. 66, datë 30.8.2006, "Për miratimin e udhëzimit 'Mbi mënyrën e llogaritjes së fiksit të kursit të këmbimit të lekut në Bankën e Shqipërisë"'.

Ky udhëzim hyn në fuqi më datë 1 korrik 2021 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR I KËSHILLIT MBIKËQYRËS
Gent Sejko

NJOFTIM
Nr. 6822, datë 7.6.2021

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË MARRËVESHJEJE NDËRKOMBËTARE

Marrëveshja për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Emirateve të Bashkuara Arabe ka hyrë në fuqi më datë 3.6.2021.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
I MINISTRISË PËR EVROPËN DHE
PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

KËRKESË
Nr. 4675, datë 4.6.2021

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë shpall kërkesën për shpronësim për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Rikonstruksion i rrugës 'Mujo Ulqinaku' (segmenti i dytë) dhe rrugës 'Jakov Mile' (segmenti i parë), Fier".

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkua Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 948,236 (nëntëqind e dyzet e tetë mijë e dyqind e tridhjetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDËSMINISTËR I
INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
Etjen Xhafaj

LISTA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "PËR DISA SHTESA NË VKM-në NR. 577, DATË 3.8.2016, 'PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI 'RIKONSTRUKSION I RRUGËS 'MUJO ULQINAKU' (SEG. I DYTË) DHE RRUGËS 'JAKOV MILE', FIER"", TË NDRYSHUAR

Nr.	Emër Atësi Mbiemër	Zona kadas.	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip. shpronësimi Tokë truall m²	Çmimi Tokë truall m²	Vlera e tokës truall (lek)	Vlera totale/lek	Shënime
2	Kafaze Arif Saliaj Ilmi Nazif Saliaj Altin Nazif Saliaj Fatmir Nazif Saliaj	8533	6/502	Truall+ndërtesë	34.5	11,026.00	380,397.00	380,397.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
2	Kostandin Jani Boçova; Leonora Jani Shkurta; Theodhor Jani Boçova; Zhaneta Jani Mone; Virgjina Jani Petani; Sofie Jani Kule; Vasillaq Jani Boçova; Arsino Jani Boçova	8533	7/929	Truall	51.5	11,026.00	567,839.00	567,839.00	Konfirmuar nga SHK-ja Pezullon veprimet, shpronësuar me VKM-në nr. 577, datë 3.8.2016
			Vlera totale e shpronësimit					**948,236.00**	

Shënim. Vlerësimi i tokës truall është llogaritur bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

KËRKESË

Shtetasja Marie Prifti (Feride Daja) kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat shpalljen të zhdukur të shtetases Marsije Daja, e datëlindjes 1.3.1974.

KËRKUES
Marie Prifti (Feride Daja)

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 89
Datë: 2021/06/09 15:03:54
0a429937-d699-4c4a-b3d1-94d146f4ac60

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë